

1 E mërkurë, 22 maj 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 [I akuzuari Krasniqi paraqitet përmes  
5 videolidhjes]

6 --- Seanca fillon në orën 09.00

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Sekretare  
8 e Seancës, ju lutemi paraqisni lëndën.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar  
10 Gjykatës, kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i  
11 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep  
12 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes  
14 të gjithëve.

15 Vërej për procesverbal që të akuzuarit janë të pranishëm  
16 në sallën e gjyqit, me përjashtim të z. Krasniqi që na ndjek  
17 përmes videolidhjes.

18 Sot do të rifillojmë me dëshminë e dëshmitarit të  
19 Prokurorisë 03881.

20 Znj. Sekretare e seancës, ju lutem sillni dëshmitarin në  
21 sallë.

22 A ka pyetje të tjera Prokuroria?

23 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Po të nderuar Gjykatës, maksimumi  
24 dhjetë minuta të tjera na duhen.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Shumë

1 faleminderit.

2 [Dëshmitar vijon dëshminë]

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes,  
4 Dëshmitar. Dëgjoni?

5 DËSHMITARI: [Përkthim] Mirëmëngjes, i nderuar Gjykatës.  
6 Dëgjoj shumë mirë.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

8 Dëshmitar, sot do të vazhdojmë me dëshminë tuaj. Sikurse  
9 dhe e thamë dhe dje mundohuni që të jepni përgjigje pyetjeve  
10 me fjali të shkurtra dhe të qarta. Nëse nuk e kuptoni pyetjen,  
11 lirisht mund t'i tregoni prokurorit ose avokatëve që nuk e  
12 kuptoni pyetjen dhe ata do të përpiqen që ta sqarojnë më tej  
13 atë.

14 Po ashtu, na thoni se ku mbështetet njohuria dhe faktet  
15 apo rrethanat për pyetjet për të cilat do t'ju bëjnë palët.

16 Ju lutem, flisni përpara mikrofonit dhe bëni një pauzë  
17 për pesë sekonda përpara se sa të t'i përgjigjeni pyetjeve. Po  
18 ashtu, ju lutem, flisni ngadalë në mënyrë të tillë që t'i  
19 lejoni kohë të mjaftueshme përkthyesve për t'ju kapur.

20 Po ashtu, në qoftë se unë do të ngre dorën, sikurse ju  
21 thashë dhe dje, apo do t'ju kërkoj që të mos flisni më, do ju  
22 kërkoja që të ndërprisni të folurin, sepse kjo tregon që duhet  
23 t'ju jap disa udhëzime.

24 Në qoftë se keni nevojë për pushime, mund të na e thoni  
25 këtë gjë dhe ne do të bëjmë organizimet e nevojshme.

1 Prokuroria, e cila është e ulur në të majtën tuaj, do të  
2 vazhdojë tani me pyetjet e radhës.

3 Znj. Prokurore e keni fjalën ju tani.

4 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Faleminderit të nderuar Gjykatës.

5 DËSHMITARI: JOHANN FRITSCH [Vijon]

6 [Dëshmitari përgjigjet përmes përkthyesit]

7 Pyetje nga znj. Iodice: [Vazhdim]

8 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

9 PY. Mirëmëngjes, Dëshmitar. Gjatë intervistës me ZPS-në keni  
10 folur për uniformat e UÇK-së që keni parë.

11 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Dhe për procesverbal, uniforma --  
12 referenca është në provën materiale P1191.2.

13 PY. Tani dua t'ju tregoj një video.

14 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares së  
15 seancës që të paraqesë në ekran tani dokumentin ERN 068357-01.

16 Të nderuar Gjykatës, një pjesë e kësaj prove materiale  
17 është pranuar si dokument, pra si provë, për këtë çështje  
18 gjyqësore dhe ka numrin P00503.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

20 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

21 PY. Këtë video do ta transmetoj që nga fillimi dhe do të  
22 ndaloj në pjesë të caktuara dhe do t'ju bëj disa pyetje pastaj  
23 lidhur me pjesët përkatëse.

24 [Luhet videoincizimi]

25 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Ju lutem, ndalojeni videon në

1 sekondën e 18.

2 [Luhet videoincizimi]

3 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

4 PY. Dëshmitar, a vutë re uniformën, a keni vënë re uniforma  
5 të zeza të ngjashme me uniformën që ka veshur njëri prej  
6 personave që keni në ekran?

7 PË. Po, relativisht shpesh në ato ditë janë parë uniforma të  
8 tilla.

9 PY. Cilat formacione i vishnin këto uniforma?

10 PË. Sa i takon kësaj fotografie, nuk jam i sigurt. Mendoj që  
11 ka qenë një lloj policie ose ndoshta policia ushtarake e UÇK-  
12 së.

13 PY. Faleminderit.

14 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares tani që  
15 të vazhdojmë deri në 00:46, pra në sekondën e 46.

16 [Luhet videoincizimi]

17 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

18 PY. Dëshmitar, a është ky një shembull i uniformave të  
19 përziera në të cilat i keni parë ushtarët e UÇK-së në atë  
20 kohë?

21 PË. Po, kishte përzierje të ndryshme të uniformave të  
22 pjesshme, pra kishte uniforma të ndryshme, kishte persona të  
23 cilët ishin të veshur me të zeza. Disa ishin të veshur me  
24 uniforma lara-lara. Disa ishin të veshur me uniforma të  
25 përziera, e të tjerë. Megjithatë, pjesa më e madhe e tyre

1 kishin një shenjë dalluese që ishte shqiponja e zezë.

2 PY. Në rregull.

3 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares që tani  
4 të vazhdojë më tej në transmetimin e videos deri në minutin e  
5 parë.

6 [Luhet videoincizimi]

7 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

8 PY. A e njihni këtë person, Dëshmitar?

9 PË. Po, ky është Kolonel Bescht, është zëvendëskomandanti i  
10 Brigadës Shumëkombëshe që drejtohej nga Ushtria Federale  
11 Gjermane.

12 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Le të vazhdojmë të shikojmë  
13 videon tani deri në 01:34.

14 [Luhet videoincizimi]

15 PËRKTHYESI: "Sapo kemi rënë dakord që nga mesnata sot nuk  
16 mund të mbahen më armë në qytetin e Prizrenit, as nga UÇK-ja  
17 dhe as nga askush tjetër. Dhe si rezultat ne kemi autoritet  
18 apo kemi kompetencë që të marrim armë prej gjithsecilit të  
19 cilin e shohim me armë."

20 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

21 PY. Dëshmitar, në këtë pamje që keni përpara, dhe në qoftë se  
22 do të bëni lidhjen me atë çfarë ka ndodhur në Prizren në atë  
23 kohë, a keni parë patrullime të UÇK-së në rrugë gjatë asaj  
24 periudhe?

25 PË. Po, gjatë ditëve të para pasi ne u futëm në vend,

1 domethënë mbas datës 13 dhe 14 qershor dhe për një periudhë  
2 relativisht të shkurtër kohe i kemi parë këto gjëra.

3 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Tani do i kërkoja Sekretares që  
4 të transmetojë videon deri në fund.

5 [Luhet videoincizimi]

6 "Ça arme kena tani automat s'është me rëndësi. Nuk kemi  
7 armët e randa të cilat kundërshtojmë. Mbase që kanë hi forcat  
8 e huaja, mund ta mbajnë edhe rregullin me ndihmën e policisë  
9 ushtarake."

10 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

11 PY. Në fund fare të videos, ishin disa njerëz ose shumë  
12 njerëz me uniformë. A janë këto llojet e uniformave që keni  
13 parë gjatë kohës kur keni qenë aty, Dëshmitar?

14 PË. Po, këto ishin lloje të uniformave që kemi parë kur kemi  
15 qenë aty.

16 PY. Në qoftë se do t'i kthehemi përsëri pyetjes të mëparshme  
17 që, siç e thatë në rreshtin 23 apo 25 më saktë, në  
18 transkriptin e ditës së sotme, që keni parë ushtarë të UÇK-së  
19 që patrullonin në rrugë gjatë ditëve të para. Sipas vlerësimit  
20 tuaj, pse bëhej patrullimi i rrugëve nga ushtarët e UÇK-së në  
21 atë kohë?

22 PË. Kur forcat e KFOR-it u futën në Kosovë, pala jugosllave  
23 duhej që të tërhiqej sipas marrëveshjes, pra duhej që të  
24 tërhiqej nga Kosova brenda pak ditëve. Pra, forcat e KFOR-it  
25 po futeshin në Kosovë, dhe për një periudhë të shkurtër kohe

1 ekzistoi një lloj vakumi, dhe UÇK-ja donte që ta mbushte këtë  
2 vakum. Pra, kjo fillonte që në kufi me Shqipërinë dhe vazhduan  
3 ata pra të UÇK-së që të bënin disa patrullime në qytet.  
4 Megjithatë, kjo është një situatë e cila ndaloi në momentin  
5 kur KFOR-i u fut në vend pas disa ditësh.  
6 PY. Faleminderit.

7 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në qoftë se  
8 më lejoni, tani dëshiroj që t'i tregoj një deklaratë të  
9 mëhershme dëshmitarit. Dëshiroj t'i kërkoj Sekretares që të  
10 paraqesë në ekran dokumentin ERN 120510-120513.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju jepet leja  
12 që t'i tregoni këtë dokument.

13 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Faleminderit.

14 Të kalojmë tek faqja 2, paragrafi 3 i këtij dokumenti.

15 PY. Dëshmitar, kur jua tregova këtë video gjatë seancës  
16 përgatitore ju thatë si më poshtë:

17 "Në këtë video tregohen anëtarë të UÇK-së duke treguar  
18 kompetencat ose autoritetin e tyre derisa u fut NATO-ja, KFOR-  
19 i dhe derisa NATO dhe KFOR-i e ndaloi këtë pas marrëveshjes së  
20 arritur".

21 A ju kujtohet ta keni thënë këtë, Dëshmitar?

22 PË. Po. Prania e armatosur e anëtarëve të UÇK-së dhe  
23 patrullimet e UÇK-së, kjo është diçka që ka ndodhur ato ditët  
24 e para, për pak ditë. Megjithatë, pas hyrjes në fuqi të  
25 marrëveshjes së KFOR-it, pra u arrit marrëveshja për

1 çarmatosjen e UÇK-së. Pas kësaj kohe, ne kemi parë vetëm një  
2 numër të vogël të anëtarëve të UÇK-së që mbanin ende armë që  
3 ishin elementë ose ishin persona të cilët merreshin me  
4 sigurinë e komandantëve ose të liderëve të caktuar. Dhe me sa  
5 më kujtohet mua, KFOR-i e toleronte këtë lloj sjellje të  
6 armatosur.

7 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Ky është fundi i pyetjeve të mia,  
8 për momentin, dhe do kërkoja që të regjistrohet si provë  
9 materiale edhe pjesa e mbetur e videos. E thashë edhe më herët  
10 që pjesa nga fillim deri në sekondin 10 të videos që sapo pamë  
11 është e pranuar si provë materiale. Po kërkoj tani që të  
12 pranohet pjesa e mbetur e të njëjtës video, domethënë nga  
13 sekondi i 10 deri në sekondin e 54, ndërkohë që dokumenti i  
14 mëhershëm ka numrin e provës materiale P00503-ET.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka ndonjë  
16 kundërshtim nga palët për shtimin e pjesës së mbetur të  
17 videos?

18 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Jo.

19 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Jo.

20 Z. ROBERTS: [Përkthim] Jo, nuk kemi kundërshtim.

21 Z. BAIESU: [Përkthim] Jo.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

23 Atëherë, e gjithë videoja në tërësinë e saj pranohet si provë  
24 materiale.

25 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës



1 këshillohen]

2 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Pjesa përkatëse do të  
3 shtohet tek prova materiale P00503.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.  
5 Mbrojtja e z. Thaçi.

6 Ekipet e Mbrojtjes do të kenë disa pyetje për ju,  
7 Dëshmitar, tani.

8 Pyetje të palës tjetër nga znj. Tavakoli:

9 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

10 PY. Mirëmengjes, Dëshmitar. Unë quhem Nina Tavakoli dhe jam  
11 përfaqësuese e z. Thaçi.

12 PË. Mirëmengjes.

13 PY. Ju u dislokuat në Kosovë më 14 qershor 1999 dhe keni  
14 qëndruar në Kosovë deri më 3 gusht 1999, a është e saktë kjo?

15 PË. Po.

16 PY. Roli juaj dhe për shkak të faktit që ju zakonisht  
17 shoqëronit shtypin, roli juaj përfshinte shumë udhëtime,  
18 domethënë keni udhëtuar në zonën e Prishtinës, të Prizrenit  
19 apo edhe në zona të tjera, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

20 PË. Po, kam udhëtuar deri në Prishtinë, por gjithashtu edhe  
21 në vende të tjera në Kosovë.

22 PY. Ju thatë që shefi i KFOR-it gjerman ishte Brigadier i  
23 Përgjithshëm Von Korff dhe zëvendësi i tij ishte Kolonel  
24 Bescht, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

25 PË. Gjeneral Von Korff ishte komandanti i Brigadës

1 Shumëkombëshe South ndërkohë që Koloneli Bescht ishte  
2 zëvendësuesi i tij. Sa i takon forcave kombëtare gjermane,  
3 drejtues ishte Brigadier i Përgjithshëm Harff.  
4 PY. Në pozicionin tuaj atje, a keni shpenzuar shumë kohë me  
5 këta dy persona?

6 PË. Në muajt që kam qenë në Kosovë, kam shpenzuar goxha kohë  
7 si me Gjeneralin Von Korff ashtu edhe me Kolonelin Bescht.  
8 Ndërkohë që sa i takon Harff, Harff e kam takuar vetëm disa  
9 herë.

10 PY. Faleminderit. Kur KFOR-i është futur në Kosovë, ju jeni  
11 mirëpritur nga njerëzit atje, apo jo?

12 PË. Po. Dhe ata ishin miqësorë. Po, jemi pritur miqësisht.

13 PY. Jo vetëm kaq, por ka pasur edhe një thirrje në kor,  
14 "NATO, NATO, UÇK, UÇK", apo jo?

15 PË. Po, "NATO, UÇK", po, po. Shumë njerëz domethënë  
16 brohorisnin me këto terma. Jemi pritur në mënyrë shumë  
17 miqësore sepse e kam fjalën këtu për atë pjesë të popullatës  
18 që po na priste neve. Po, jemi mirëpritur mirë.

19 PY. Dhe jo vetëm kaq, por kishte edhe shumë të shtëna në ajër  
20 për të festuar mbërritjen tuaj, apo jo, Dëshmitar?

21 PË. Po, shumë. Ajo nuk ishte hera ime e parë në Ballkan dhe  
22 unë e dija që kjo është diçka që ndodhte në mënyrë të  
23 zakonshme në atë rajon.

24 PY. Pra, me fjalë të tjera, ka shumë armë në Ballkan, apo jo?

25 A është e drejtë kjo të thuhet, Dëshmitar?

1 PË. Po.

2 PY. Ushtria jugosllave ishte ende e pranishme kur keni  
3 mbërritur ju, sepse sipas marrëveshjes, kishte një tërheqje  
4 graduale të trupave të tyre, a është e vërtetë kjo, Dëshmitar?

5 PË. Po. Pjesë të Ushtrisë popullore të Jugosllavisë,  
6 domethënë ajo pjesë që kishte mbetur prej saj, ishin të  
7 pranishme aty, por kishte gjithashtu edhe forca të sigurimit.  
8 Një prej detyrave kryesore që kishim ne gjatë ditëve të para  
9 kur kemi mbërritur ishte që të futeshim në grupet ndërluftuese  
10 dhe që të pengonim konfrontimet ose përleshjet e mëtejshme, si  
11 ndërmjet popullatës civile kosovare dhe forcave që po  
12 largoheshin apo po tërhiqeshin, të ushtrisë popullore të  
13 Jugosllavisë.

14 PY. UÇK-ja ishte ende në atë kohë e armatosur për shkak të  
15 marrëveshjes së çmilitarizimit që është rënë dakord nga  
16 Gjenerali Mike Jackson dhe UÇK-ja, se kjo marrëveshje nuk  
17 ishte nënshkruar. Është nënshkruar vetëm më datë 21 qershor,  
18 apo jo?

19 PË. Po, mendoj që është nënshkruar nga data 20 ose 21  
20 qershor. Por përpara kësaj periudhe, ka pasur shumë ushtarë të  
21 armatosur të UÇK-së. Megjithatë, ne jemi përpjekur që t'i  
22 çarmatosim ata edhe kur kemi shpërbërë pikat e kontrollit.  
23 Megjithatë, UÇK-ja, anëtarët e UÇK-së, ishin të dallueshëm për  
24 shkak të elementëve të ndryshëm që kishin në veshjet e tyre  
25 sepse zakonisht kishin të veshur logon e UÇK-së, mbanin edhe

1 shirita identifikues të shqiptarëve me dy koka, shqiptare.  
2 PY. Faleminderit. Ne e dimë që ka pas një marrëveshje në  
3 Prishtinë për çarmatimin e UÇK-së, megjithatë, marrëveshja  
4 përfundimtare detyruese ishte marrëveshja që është nënshkruar  
5 nga Gjenerali Mike Jackson më 21 qershor, apo jo, Dëshmitar?  
6 Faleminderit.

7 Tani, a pajtoheni me Kolonelin Bescht që ka dhënë lidhur  
8 me situatën e sigurisë në fillim si më poshtë. Për  
9 procesverbal, referenca është 077406, faqja 4. Ai thotë si më  
10 poshtë:

11 "Situata e sigurimit ishte e tensionuar që prej fillimit.  
12 Kjo shprehej nga të shtënat e vazhdueshme në ajër gjithashtu  
13 edhe gjatë natës. UÇK-ja po luftonte ndërmjet vetes në atë  
14 kohë, por gjithashtu edhe me serbët".

15 A do të pajtoheshit me këtë deklaratë të bërë nga kolegu  
16 juaj?

17 PË. Po, situata ishte shumë e tensionuar. Kishte pjesë të  
18 popullsisë kosovare që ishin shumë të inatosur dhe të  
19 brengosur dhe ishin shumë të prekur nga ajo çfarë kishte  
20 ndodhur. Ndërkohë që serbët apo jugosllavët, ata që po  
21 largoheshin, ishin të frikësuar, disa prej tyre. Pra, pragu i  
22 dhunës ishte shumë i ulët, kështu që detyra jonë kryesore  
23 ishte që të mos lejonim më konfrontime ose përleshje të tjera.  
24 Këtë ne e kemi arritur përmes pranisë së konsiderueshme  
25 ushtarake, edhe pse na u desh goxha kohë që këtë prani të mund

1 ta shtrinim në të gjithë rajonin.  
2 PY. Do e cekim temën e pragut të ulët të dhunës pak më pas.  
3 Megjithatë, për momentin, më lejoni të bëj këtë pyetje. Kjo  
4 popullsia civile për të cilën po flisni, në momentin kur ju u  
5 futët në Kosovë, pra civilët shqiptarë të Kosovës që ishin  
6 dëbuar nga serbët, po ktheheshin mbrapsht në shtëpitë e tyre  
7 në numra të konsiderueshëm, apo jo? Besoj që i thatë, i keni  
8 thënë ZPS-së, dhe më lejoni një çast të gjej referencën për  
9 këtë -- atëherë, për procesverbal referenca është prova  
10 P01191.2, rreshtat 16, 17.

11 I thatë ZPS-së që në atë kohë ka pasur më shumë se sa  
12 20.000 njerëz që po ktheheshin përmes kufirit. A ju kujtohet  
13 ta keni thënë këtë, Dëshmitar?

14 PË. Në qoftë se më lejoni, dua ta shtjelloj pak më tepër  
15 këtë. Unë kam mbërritur në Maqedoni bashkë me kolegët e mi në  
16 mars, dhe kemi krijuar atje kampe refugjatësh dhe i kemi  
17 menaxhuar ata. Domethënë, këto ishin kampe refugjatësh për  
18 personat që ishin larguar nga Kosova.

19 Kur u futëm në Kosovë, kishte disa mijëra shqiptarë të  
20 Kosovës që ishin ende ose në Shqipëri ose në Maqedoni. Disa  
21 prej tyre u futën në automjete dhe na ndoqën ne, ndoqën  
22 autokolonat tona për të kaluar kufirin.

23 PY. Në atë kohë keni shkruar një ditar, dje na thatë që  
24 ditarin e keni mbajtur çdo mbrëmje, në mënyrë të tillë që të  
25 regjistronit përvojën tuaj në Kosovë. A është e vërtetë kjo,

1 Dëshmitar?

2 PË. Po. Është një ditë lidhur me ato çfarë unë kisha parë  
3 gjatë ditës. Ndonjëherë përshkrimet e thëna në këtë ditë janë  
4 të shkurtër, ndonjëherë janë edhe më të elaboruara edhe më të  
5 zgjatura, ndonjëherë janë vetëm thjesht mendimet e mia lidhur  
6 me atë çfarë ndodhte gjatë ditës.

7 PY. Në rregull. Do t'ju bëj disa pyetje që kanë të bëjnë me  
8 pjesë të caktuara të këtij ditari.

9 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Së pari, dua t'ju kërkoj ju,  
10 Sekretare, që të paraqisni një dokument në ekran që është  
11 071142 deri në 071313. Numri ERN është i njëjti edhe në  
12 gjermanisht. Më konkretisht dua të paraqitet në ekran faqja  
13 071220.

14 PY. Kalojmë tek paragrafi i dytë, do ju kërkoj t'i hidhni  
15 një sy këtij paragrafi. Këtu ju flisni lidhur me atë çfarë  
16 ndodhte me refugjatët që po ktheheshin. Shënimi që keni marrë  
17 është si më poshtë:

18 "Duhet që të shikohen më afër krimet e pronësisë,  
19 vjedhjet, plaçkitjet: refugjatët që kthehen i gjejnë shtëpitë  
20 e tyre të djegura. Po ashtu edhe pronat e tyre janë ose të  
21 shkatërruara ose janë të vjedhura. Kjo është një shtëpi serbe  
22 ose një apartament diku aty afër. Po ashtu edhe mallrat e  
23 tjera dhe gjërat e tjera në shtëpi janë të shkatërruara.  
24 Sigurisht që kjo është e paligjshme, por është ndryshe nga  
25 plaçkitja nga banditët..."

1 A ju kujtohet kjo, Dëshmitar?

2 PË. Po, më kujtohet. Kemi parë gjëra së bashku me persona të  
3 tjerë për individë, për gjëra individuale, për shembull unë  
4 kam ndaluar vetë plaçkitësit, vjedhësit dhe jua kam marrë  
5 gjërat që ata kishin marrë nga shtëpitë dhe i kam dorëzuar ata  
6 tek policia ushtarake.

7 PY. A sugjerohet në këtë, në këtë pjesë, që refugjatët po  
8 ktheheshin në shtëpitë e tyre dhe i gjenin shtëpitë e tyre  
9 pjesa më e madhe të shkatërruara dhe gjërat e shtëpive të  
10 vjedhura? Kjo është ajo që ju sugjeroni?

11 PË. Personat që ktheheshin në këto qytete ose fshatra, disa  
12 prej tyre nuk kishin asgjë tjetër ,s'u kishte mbetur  
13 absolutisht asgjë përveç rrobave të trupit. Shtëpitë e tyre  
14 ishin të shkatërruara, të djegura, nuk është se kishin  
15 absolutisht asnjë gjë. Disa prej tyre shkuan në shtëpitë e  
16 mbetura bosh të serbëve për të gjetur gjërat e tyre. Një lloj  
17 forme për të kompensuar atë çfarë kishin humbur.

18 PY. Kush i kishte djegur shtëpitë dhe kush kishte vjedhur  
19 plaçkat e shtëpive të tyre, serbët? Ndërkohë që po  
20 largoheshin, ata i kishin bërë këto veprime?

21 PË. Me aq sa di unë, pjesa më e madhe e shqiptarëve të  
22 Kosovës, shtëpitë e të cilëve ishin shkatërruar apo ishin  
23 djegur, pjesa më e madhe e tyre ishin viktimat të dhunës serbe  
24 gjatë luftës në Kosovë ose gjatë ditëve të fundit të pranisë  
25 së serbëve atje.

1 PY. Është pak përgjithësuese, por kosovarët në atë kohë kanë  
2 qenë relativisht të varfër, pra ishte gjë e rëndë që të  
3 humbisnin gjëra e tyre personale, pronat e tyre.

4 PË. Po flasim për një gjendje pas luftës e ngjashme me  
5 gjendjen në Bosnjë dhe Hercegovinë në atë kohë. Pra, pasojat e  
6 luftës, plaçkitja, shkatërrimi, pra karakteristikat e  
7 zakonshme që shihen në një gjendje të tillë.

8 PY. Faleminderit. Në këtë prani të përzier me civilët, pra  
9 edhe këtë e keni shënuar, shkruar edhe në ditarin tuaj --

10 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Në faqen 071190, i njëjti  
11 ditar, në qoftë se mund ta shfaqim në ekran. Paragrafi i dytë.

12 PY. "Banditët shqiptarë vazhdojnë të kalojnë kufirin dhe  
13 vjedhin, plaçkisnin..."

14 Pra, elementë kriminalë shqiptarë po futeshin në vend, në  
15 territorin në të njëjtën kohë, apo jo?

16 PË. Po, me sa më kujtohet kjo është e vërtetë. Megjithatë,  
17 tani pikat e kalimit, kufitare, për shembull në Morinë, janë  
18 siguruar dhe kontrolluar relativisht shpejt nga forcat e KFOR-  
19 it. Pra kjo ndërpreu, u dha fund kësaj relativisht shpejt.  
20 Gjërat që lexoni këtu i referohen një dite apo disa ditëve,  
21 domethënë që --

22 PY. Në fakt kështu është, dhe na ndihmon kjo sepse data aty  
23 është 19 qershor. Duhet ta kisha lexuar, të kërkoj ndjesë.

24 Tani i keni deklaruar ZPS-së dhe kjo referenca për këtë  
25 është P01191.3, në faqet 28, 29. Dhe bëhet fjalë për ditët e



1 para, dhe thatë që :

2 "Ditët e para ishte relativisht kaotike gjendja. Jemi, u  
3 përpoqëm që të vendoseshim në të gjitha zonat e mundshme dhe  
4 të krijonim një ambient të sigurt, të krijonim siguri në atë  
5 kohë. Ka patur incidente, vrasje, zjarrvënie, gjithandej."

6 Ju kujtohet kjo?

7 PË. Po, më kujtohet. Detyra e parë e KFOR-it ishte të  
8 vendoseshin në të gjithë rajonin, me qëllim që të sigurohej  
9 largimi i forcave jugosllave serbe. Kjo ishte detyra e parë,  
10 ditët e para. Qëllimi ishte, synimi ishte të shmangeshin  
11 përballje, përplasje të tjera mes forcave të sigurisë që  
12 përmenda dhe kosovarëve. Në të njëjtën kohë, forcat e KFOR-it,  
13 përfshirë dhe brigadën time në jug, duhet të shkonin në vendet  
14 e ndryshme dhe pastaj të shpërndareshin dhe të mbulonin të  
15 gjithë territorin e Kosovës dhe natyrisht që për të bërë këtë  
16 janë dashur disa ditë. Gjatë këtyre ditëve, ndërkohë që po  
17 shtriheshim dhe vendoseshim në të gjithë territorin, kemi  
18 hasur vazhdimisht në vende të ndryshme vende, pra kemi shkuar  
19 në vende ku kemi parë masakrat që ishin bërë, vrasje dhe  
20 shkatërrime.

21 PY. Tani do kaloj ndoshta në këto, pak më në hollësi meqenëse  
22 ju e përmendët. Pra, këta refugjatë që po ktheheshin, gjenin  
23 familjet e tyre, miqtë e tyre që ishin vrarë nga serbët dhe  
24 trupat e tyre ishin në varreza masive, apo jo?

25 PË. Forcat e KFOR-it, pra ne, kemi zbuluar varreza masive,

1 por njëkohësisht kemi zbuluar vende ku një, personat e vrarë  
2 ishin akoma të shtrirë në tokë, mbi sipërfaqe, të pavarrosur.  
3 Dhe popullsia civile na dha informacion për vendet e ndryshme  
4 të tilla ku kishin ndodhur këto gjëra.

5 PY. Do të doja që të shkojmë në tre pjesë të ndryshme të  
6 ditarit tuaj ku keni detajuar, dhënë hollësi, duke shpjeguar  
7 këtë gjë.

8 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Në qoftë se mund të shfaqim në  
9 ekran faqen 071152, paragrafi i dytë.

10 PY. Këtë e keni shkruar më 15 qershor 1999:

11 "Në Krushë të Vogël, kolegët tanë holandezë kanë gjetur  
12 një 'vendngjarje të një krimi' në një oborr. Shkova aty në  
13 orën 17.30. vendi ishte i shkatërruar për pjesën më të madhe,  
14 në oborr vinte një erë shumë e fortë e kufomave. Së pari,  
15 pashë një qen të vdekur, të ngordhur, pastaj një traktor,  
16 rimorkio, të djegur. Pjesë të trupave të kufomave të prera, të  
17 shkatërruara. Në një shtëpi të vogël tërësisht të shkatërruar  
18 kishte kufoma të prishura. 20-25 vetë, nga fëmijët e vegjël  
19 deri tek mosha të rritura, të vjetër, të moshuar. Të vrarë dhe  
20 të djegur. Plumba, brima plumbash në trup, të shtrirë në tokë.  
21 Dhe të gjithë ishin të qëlluar me armë. Njerëzit kishin vdekur  
22 në fund marsit. Kur pashë këtë e dija saktësisht se pse isha  
23 në Kosovë, për t'i dhënë fund kësaj!"

24 PË. Po.

25 PY. Për çfarë e keni fjalën saktësisht kur thoni që për së

1 pari ishit në Kosovë për t'i dhënë fund kësaj?

2 PË. Ne e dinim nga shtëpi dhe publikimet në shtyp dhe  
3 informacionet e inteligjencës ushtarake, pra atë që kishte  
4 ndodhur në Kosovë, gjatë luftës në Kosovë sa i përket mizorive  
5 të mundshme që ishin kryer kundër popullsisë shqiptare. Por  
6 edhe pse, kur je ushtar me përvojë dhe ke parë shumë gjëra,  
7 nuk harrohet kurrë një vend i tillë siç e kam përshkruar këtu.

8 Në atë moment secili prej nesh kuptoi se ishte gjëja e  
9 duhur për KFOR-in që të vinte dhe t'i jepte fund luftës. Këto  
10 gjëra nuk harrohen kurrë. Këto qëndrojnë me juve gjithmonë.

11 PY. Faleminderit. Kam edhe dy pjesë të tjera për Gjykatën nga  
12 ditari.

13 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Në qoftë se mund të shfaqim  
14 faqen 071170.

15 PY. Ky shënim në ditar është i datës 17 qershor, pra dy ditë  
16 më pas.

17 ZNJ. IODICE: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, kundërshtoj  
18 këtë seri pyetjesh sepse është dyfishim i çështjeve tashmë të  
19 gjykuara më parë nga Mbrojtja, në veçanti sa i takon faktit  
20 746 i pranuar në dokumentin F01536.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet  
22 kundërshtimi. Vazhdoni.

23 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Edhe në qoftë se mund të shkoj  
24 në gjysmë të faqes, dhe të shohim:

25 PY. "Në zonën e Rahovecit udhëtoj me holandezët. Vjen një erë

1 e fortë e kufomave, kufomash, afër spitalit. Nuk mund të  
2 shkojmë më tej, megjithatë, sepse rruga është e paasfaltuar  
3 dhe nuk është e kontrolluar nëse ka mina apo jo. Menjëherë më  
4 pas një oficer holandez na tregon kockat e fëmijëve në një  
5 kazan plehrash. Kafshët i kanë nxjerrur brinjët e dy deri në  
6 tre vjeç, e një fëmije që ishte i moshës dy ose tre vjeç, në  
7 anë të rrugës. Ata, pra serbët, kanë vrarë fëmijët dhe i kanë  
8 hedhë trupat në kosh të plehrave. Nuk mund të afrohem më  
9 shumë ndaj mbetjeve të trupit dhe 6 trupa të tjerë, të 6  
10 trupave të tjerë, sepse zona nuk është kontrolluar nëse ka  
11 mina apo jo. Policia ushtarake do të përdorë ndoshta kafkën  
12 për të [Korrigjim i përkthyesit: një vinç] për të arritur dhe  
13 për të kapur trupat nga sipër. Trupat ishin të prerë në copa  
14 nga krimbat, nga mizat, nga qentë...”

15 A ju kujtohet që e keni shkruar këtë?

16 PË. Po, kjo ka qenë një prej shumë ditëve gjatë të cilave  
17 kemi gjetur gjëra të tilla dhe zakonisht ne informonim  
18 policinë ushtarake për gjendje të tilla dhe pastaj pjesëtarë  
19 të policisë angleze dhe organizatat e tjera të policisë erdhën  
20 në Kosovë për të bërë hetime masive të këtyre ngjarjeve. Po  
21 ashtu ishin, kishte doktorë që kanë bërë analiza pas vdekjes,  
22 pra, patologjike, të këtyre varrezave kur janë hapur këto  
23 varreza masive. Dhe kjo nuk ishte më detyrë e KFOR-it. Ishte  
24 detyrë ndërkombëtare që u mor përsipër nga organizatat e  
25 tjera.

1 PY. Dhe mendoj që keni thënë, duke iu referuar Scotland Yard,  
2 pra policisë britanike, në ditarin tuaj të datës 16 qershor.

3 Nuk kemi nevojë ta shfaqim në ekran. Por ju keni shkruar aty:

4 "Sipas ekspertëve britanikë, më shumë se 10 000 janë  
5 vrarë nga serbët ose kanë humbur jetët e tyre në forma të  
6 tjera gjatë spastrimit etnik."

7 Është kjo që britanikët ju kanë thënë ju, apo jo?

8 PË. Nëse e kam shkruar aty, do të thotë se e kam marrë nga  
9 burime britanike.

10 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Ndoshta mund ta shfaqim në  
11 ekran për nevojat e procesverbalit dhe pastaj ta dorëzojmë ose  
12 ta paraqesim si provë. Është në të njëjtin ditar, nuk duhet të  
13 shfaqet për publikun, ju lutem, nëse mund ta shfaqni në ekran  
14 faqen 071282.

15 PY. Në paragrafin e dytë ju shkruani këtua:

16 "Sipas ekspertëve britanikë..."

17 E shikoni këtë?

18 PË. Po.

19 PY. Tani, po ashtu -- Bescht ka thënë, nuk e di a pajtoheni  
20 me këtë sa i takon varrezave masive, ai ka thënë -- për  
21 procesverbal, kjo gjendet në 077406, faqe 18, se viktimat apo  
22 kufomat në këto varreza masive ishin të gjithë kosovarë.

23 Pajtoheni me këtë?

24 PË. Kjo pjesë e ditarit, ky shënim, është bërë pothuajse një  
25 muaj pas hyrjes së KFOR-it në Kosovë. Në atë kohë, në atë

1 moment, ishte e zakonshme tashmë që ne merrnim, të merrnim ne  
2 informacione nga shtypi ndërkombëtar, por pjesërisht edhe nga  
3 Ushtria Federale Gjermane. Komunikata për shtyp dhe dy të  
4 tjera, për shembull. Dhe supozoj që këto shifra të përmendura  
5 këtu janë marrë, ne i kemi marrë përmes këtyre kanaleve, pra  
6 deklarata, komunikata për shtyp, apo deklarata të organizatave  
7 të ndryshme që ishin duke trajtuar atë, duke hetuar atë që  
8 kishte ndodhur. Këto nuk janë shifrat që do të kisha mund të  
9 jepja unë.

10 PY. Faleminderit. Por nuk ishte thjesht fakti që ju i patë  
11 këto varreza, mendoj që KFOR-i ka mbajtur shënim ditare të  
12 luftës, apo jo? Kontingjenti gjerman ka mbajtur një ditar të  
13 tillë të luftës.

14 PË. Sigurisht, kontingjenti gjerman përmes kanalit kombëtar  
15 ka dhënë raporte, dorëzuar raporte komandës gjermane. Dhe  
16 supozoj batalioni i artilerisë holandez që ishin me neve, dhe  
17 më vonë edhe 120 ushtarë rusë, dhe pastaj edhe kombet e tjera,  
18 kanë bërë këtë në mënyrë të ngjashme.

19 PY. Faleminderit. Dhe ditari, neve na është dorëzuar në kopje  
20 nga Zyra e Prokurorisë, është i nënshkruar nga shefi i KFOR-it  
21 gjerman, Gjenerali Von Korff. Kjo është normal, apo jo?

22 PË. E keni fjalën gjenerali i brigadës gjermane, për pjesën  
23 operacionale?

24 PY. Po. Dokumenti që ne kemi marrur quhet ditar i luftës.

25 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Ndoshta mund ta shfaqim në

1 ekran.

2 PY. Dhe Bescht thotë, ndoshta kjo mund ta ndihmojë dhe për  
3 referencë është 077406, Pjesa 1, që ky është mbajtur për të  
4 shënuar aty çdo minutë të operacionit dhe gjithçka që  
5 vëzhgohej apo dhe që të shënohej gjithçka në mënyrë të saktë  
6 duke shënuar datën dhe kohën.

7 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Tani në qoftë se mund të  
8 shfaqim këtë në ekran, është dokumenti SITF00225092 deri në  
9 SITF00225184. Dhe versioni në gjermanisht ka numër tjetër që  
10 është SITF00224836 deri në 00225261.

11 DËSHMITARI: [Përkthim] Më lejo të them diçka, i nderuar  
12 Gjykatës lidhur me këtë ditar?

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

14 DËSHMITARI: [Përkthim] Ky ditar përmban të gjitha  
15 njohuritë që kishin policia ushtarake, këtu përfshihen raporte  
16 sa i përket patrullimeve, trupave të rekonisancës, trupave të  
17 vëzhguesve, gjithçka që është bërë dhe raportuar nga  
18 batalionet dhe nga forcat si dhe informacionet, gjetjet e  
19 shërbimeve të inteligjencës ushtarake për shkak të masave të  
20 tyre vëzhguese.

21 Të gjitha këto janë në thelb informacione që brigada  
22 merrte në baza ditore. Të gjitha këto përfshihen në ditar.

23 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

24 PY. Faleminderit. Dhe dua që të shikojmë bashkë disa prej  
25 shënimeve, gjërave të shënuara. Do të përpiqem që ta bëj këtë

1 sa më shpejt që të mundem. Dhe për të parë nëse këto përputhen  
2 me mënyrën se si ju e keni kuptuar gjendjen që KFOR-i ka  
3 konstatuar dhe gjetur aty kur kanë arritur.

4 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Pjesa e parë është në qoftë se  
5 mund të shkojmë, të kalojmë në faqen 277, e njëjta faqe në  
6 gjermanisht. Në fakt, është faqja ndryshe, është gjermanisht,  
7 kërkoj ndjesë. ERN-ja në gjermanisht është SITF00225117. Në  
8 qoftë se mund të kalojmë tek shënimi që mban datën 151612B  
9 qershor. Në anglisht është 277. Në qoftë se kalojmë, shkoni  
10 pak më poshtë, tek numri 15. Në fund të faqes është faqe,  
11 numër i faqes 277. Kërkoj ndjesë, nuk ka numër ERN.

12 PY. Atëherë, 15 qershor:

13 "Thirrje telefonike G3 KFOR-it

14 "KFOR-i informon brigadën, se brigada operationale kërkon  
15 TPNJ. (Raport për varrezë masive në Krushë të Vogël..."

16 "DM 70 85 [Sipas përkthimit].

17 E shihni këtë?

18 PË. Po.

19 PY. Dhe pastaj në qoftë se kalojmë në faqen vijuese, 277.

20 Kërkoj ndjesë, në fakt mund të vazhdojmë, të mbesim në të  
21 njëjtën faqe, jemi prapë në datën 15 qershor, në fund të  
22 faqes. Ku thuhet:

23 "Varrezë masive, raport nga brigada

24 "Në DM 854 7897 [Sipas përkthimit] një varrezë masive me  
25 rreth 40 kufoma...



1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj. Avokate  
2 Mbrojtëse, a ka ndonjë dyshim që ka pasur varreza masive?

3 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Mund të ndaloj këtu, por ajo që  
4 desha të vërtetoj është gjendja që refugjatët kosovarë,  
5 gjendja me të cilën përballeshin refugjatët kosovarë.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Refugjatët  
7 kosovarë përballeshin me varreza masive. Njerëzit i kanë  
8 zbuluar këto.

9 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Në rregull. Do ta mbarojmë këtu  
10 me këtë.

11 PY. Atëherë. Ditari pasqyronte atë që ju keni parë, a është e  
12 saktë?

13 PË. Në ditarin tim kam shkuar atë që kam parë unë kur nuk kam  
14 parë diçka vetë, zakonisht kam shkruar aty nga e kam marrë  
15 informacionin që kam shënuar në ditar.

16 PY. Faleminderit. Dhe a është e drejtë të themi që në, ky  
17 është momenti kur duke u kthyer refugjatët i kanë parë  
18 shtëpitë e tyre të djegura, pronat e tyre të vjedhura, të  
19 afërmit, të dashurit e tyre të vrarë, disa shqiptarë kosovarë  
20 janë hakmarrë?

21 PË. Po. Dhe kjo është diçka që duhet ta vërenim. Pjesërisht  
22 duhej ta parandalonim, por gjatë atyre ditëve në javët e para  
23 pas çlirimit të Kosovës, kanë ndodhur disa ngjarje agresive që  
24 kanë shkuar deri në vrasje, zjarrvënie, në anën e jo-serbëve.

25 PY. Dhe sa i takon kryesve, kush ishin kryesit, ju i keni

1 deklaruar ZPS-së dhe referenca këtu është P0019.5 në faqen 9.  
2 Kjo është në kontekstin e arrestimeve. Po e lexoj atë që është  
3 aty, që e keni thënë duke filluar prej rreth datës 20 qershor  
4 "numri i arrestimeve u rrit në mënyrë domethënëse...  
5 plaçkitësit, dhunuesit, grabitësit... u sollën, pra u ndaluan  
6 dhe u sollën tek burgu i sapokrijuar i policisë ushtarake...  
7 Kjo kishte gjithashtu pengmarrje dhe krime të tjera."

8 Dhe gjithashtu keni shkruar aty:

9 "Ishin ata që kishin sjellur civilët"?

10 Keni thënë këtë -- pra, dhe keni thënë:

11 "Ka qenë kryesisht një përmbledhje e asaj që di unë.

12 Zakonisht civilët apo njerëzit në rrobat civile."

13 A ju kujtohet që keni thënë këtë?

14 PË. Po, më kujtohet që kemi arrestuar si kryes, pjesërisht,  
15 edhe i kemi dërguar në burg që, persona që ishin pjesërisht në  
16 rroba civile dhe pjesërisht njerëz që kishin uniforma të  
17 përziera. Dhe ose nuk kishin uniformë. Dhe njerëz që ishin me  
18 uniformë dhe këto arrestime janë shtuar në numër shumë shpejt  
19 pas disa ditëve dhe në mënyrë që, dhe për rrjedhojë ish-burgu  
20 i MUP-it në Prizren u përdor nga ne për të, që duhet të gjenim  
21 një vend se ku të mbanim kryesit e arrestuar.

22 PY. A është e saktë të themi që ka patur civilë që kanë kryer  
23 krime, këto krime?

24 PË. Të paktën nga jashtë nuk ishte gjithmonë e dukshme qartë  
25 çfarë statusi kishte personi, pra, me çfarë cilësie. Por masa

1 e personave me uniformë apo me uniformë të pjesshme njiheshin  
2 si luftëtarë, por gjatë kësaj kohe këto uniforma apo uniformat  
3 e pjesshme po zhdukeshin nga rrugët.

4 PY. Faleminderit. Dhe jeni në dijeni që Komisioneri i Kombeve  
5 të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut raportoi në shtator se  
6 uniformat e UÇK-së mund të gjendeshin dhe të bliheshin për  
7 shumën 50 marka gjermane dhe që njerëzit që nuk ishin pjesë e  
8 UÇK-së po i blinin ato dhe po i vishnin.

9 PË. Këtë nuk e di.

10 PY. Po në qoftë se është kështu siç themi, që nuk duhej që  
11 një person të ishte në UÇK që të kishte një uniformë, rrjedh  
12 nga kjo apo jo, që personat që vishnin, kishin të veshur  
13 uniformë të UÇK-së dhe kryenin krime nuk ishin detyrimisht  
14 pjesëtarë të UÇK-së?

15 PË. Nuk mund të them asgjë lidhur me këtë. Nuk mund të them  
16 asgjë. Uniforma ushtarake mund të blihen kudo në botë dhe të  
17 vishen, por tani a është e vërtetë kjo që sapo tha znj.  
18 Avokate, nuk e di, nuk mund të them asgjë lidhur me këtë.

19 PY. Faleminderit. Tani, do të kthehem pak tek UÇK-ja. Ju i  
20 keni deklaruar Zyrës së Prokurorit, dhe referenca për këtë  
21 është P00191.4, faqja 7, që në të njëjtën kohë kur ju po  
22 vendoseshit të shpërndareshit dhe po përpiqeshit që të  
23 vendosnit rend, UÇK-ja në Prizren njëkohësisht po përpiqej që  
24 të merrte pushtetin. Po krijonin, po vendosnin pika kontrolli.  
25 Ju kujtohet këtë?

1 PË. Po.

2 PY. Gjithashtu iu keni deklaruar ZPS-së dhe kjo është në  
3 P00191.2, faqe 12, se kur ju është bërë pyetja nëse kjo ishte  
4 përpjekje e organizuar ju jeni përgjigjur që nuk e dinit se  
5 disa herë ishte thjesht kaotike. Ju kujtohet kjo?

6 PË. Më kujtohet kjo deklaratë. Është, gjendja ka qenë  
7 pjesërisht se menaxhimi i informacionit apo komunikimi brenda  
8 UÇK-së nuk ishte diçka që pritet nga ushtritë moderne dhe nga  
9 ana tjetër ishte gjithashtu e qartë në fotografitë që media  
10 kishte në dispozicion dhe i kam parë vetë, dhe unë e kam parë  
11 edhe vetë këtë gjë, ishte e dukshme qartë që personat që  
12 kishin të veshur uniformë dhe udhëheqësit e UÇK-së  
13 trajtoheshin me një nivel të lartë respekti dhe jepnin urdhra  
14 për, njerëzve të tyre, dhe këto urdhra zbatoheshin.

15 PY. Dhe mendoj që një përskrim tjetër që keni dhënë, dhe kjo  
16 gjendet në P00191.2, se ata nuk silleshin si ushtri e rregullt  
17 në pikat kufitare, më shumë si një bandë partizanësh. Ju  
18 kujtohet që i keni përskruar ata në këtë mënyrë?

19 PË. Po.

20 PY. Do të dua, dëshiroj të lexoj deklaratën, një deklaratë që  
21 ka dhënë koloneli Bescht lidhur me këtë përpjekje për të marrë  
22 pushtetin, pra përpjekjen e UÇK-së dhe t'ju pyes nëse ju  
23 pajtoheni me këtë. Dhe ai shkruan që:

24 "Kishte një boshllëk pushteti aty", për referencë është  
25 faqja 077406, Pjesa 1, faqja 8.

1 Pra, ai shkruan:

2 "Ka patur një vakum, boshllëk, pushteti. Organet  
3 administrative dhe civile, përfshirë policinë dhe ushtrinë  
4 ishin larguar. MUP-i nuk ishte më i pranishëm. Edhe pas  
5 marrëveshjes ata duhej të largoheshin, UÇK-ja në mënyrë të  
6 natyrshme u përpoq që të plotësonte, të mbushte këtë vakum,  
7 apo këtë boshllëk të pushtetit dhe ta bënte praninë e tyre të  
8 njohur. Ata ndjenin se ishin ushtria çlirimtare dhe natyrisht  
9 donin që të tregonin këtë popullit të tyre. Nga kjo pikëpamje  
10 kjo është e kuptueshme, por ishte në kundërshtim me misionin  
11 tuaj, misionin tonë atje."

12 PË. Sjellja ishte siç është përshkruar, sjellja e UÇK-së apo  
13 e luftëtarëve të UÇK-së ishte siç u tha. Ka patur kryesisht në  
14 ditët e para pas hyrjes së KFOR-it në Kosovë apo gjatë, pas  
15 largimit të ushtrisë jugosllave, ata u përpoqën që të  
16 plotësonin këtë boshllëk, të mbushnin këtë vakum, duke  
17 krijuar, duke vendosur pika kontrolli dhe kjo ishte e ndaluar  
18 nga KFOR-i, por është dashur pak kohë që të zbatohet.

19 PY. Dhe mendoj që ajo që po përpiqem të kuptoj këtu dhe të  
20 them është që ndoshta ka qenë e natyrshme për ta. E kanë  
21 konsideruar, ata shihnin vetveten si fitimtarë. E kishin  
22 derdhur gjak duke luftuar kundër serbëve dhe donin që të  
23 merrnin vlerat e fitimit për këtë.

24 PË. Ju lutem, a mund ta përsërisni dhe një herë pyetjen më  
25 konkretisht?

1 PY. Tani, nga ajo që kuptoj unë, sipas asaj që ka thënë  
2 Bescht, UÇK-ja është e logjikshme që të jetë përpjekur të  
3 plotësojë këtë vakum sepse ata e ndjenin që ata ishin Ushtria  
4 Çlirimtare e Kosovës dhe sigurisht që deshën t'ia tregonin  
5 këtë edhe njerëzve të tyre, popullit të tyre. Tani, nga  
6 pikëpamja humane, lejohet a s'lejohet është tjetër gjë. Por  
7 duke qenë se ata e ndjenin veten fitimtarë, deshën ta shfaqnin  
8 këtë ndjenjë, a pajtoheni me mua?

9 PË. Ka qenë fakt. Për të vlerësuar këtë fakt nuk ka qenë  
10 kompetenca ime as atëherë dhe nuk dua ta bëj as sot këtë gjë.  
11 Faleminderit.

12 PY. Ju thatë që shumë shpejt UÇK-ja i respektoi kërkesat  
13 tuaja. Kështu?

14 PË. Kur u hoqën postblloqet dhe kur u zëvendësua UÇK-ja tek  
15 pika e kalimit në Morinë, edhe lidhur me çarmatosjen, me sa  
16 kam unë dijeni nuk ka pas problematika të mëdha. Me sa kujtoj  
17 unë, marrëveshja ka qenë që të respektohej sigurisht edhe ka  
18 pasur disa problematika të vogla, por nuk më kujtohet se çfarë  
19 shkalle ka [Mikrofoni çaktivizuar] --

20 PY. I keni dokumentuar në ditarin tuaj disa prej këtyre  
21 problematikave.

22 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Do bëjmë pushimin apo doni të  
23 vazhdoj?

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nëse është e  
25 volitshme për ju.

1 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Po, tani mund ta bëjmë pushimin.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, do  
3 të bëjmë rreth 15 minuta pushim, do të kthehemi sërish në  
4 sallën e gjyqit që të vijojmë me kundërpjetet. Mos harroni që  
5 nuk duhet të flisni me askënd për dëshminë tuaj këtu në sallë.

6 DËSHMITARI: [Përkthim] Po.

7 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

9 --- Seanca ndërpritet në orën 10.05

10 --- Seanca rifillon në orën 10.21

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Asistente, ju  
12 lutem mund të sillni dëshmitarin.

13 [Dëshmitari vijon dëshminë]

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,  
15 Dëshmitar. Do të vazhdojmë me pyetjet e znj. Tavakoli.

16 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

17 PY. Faleminderit. Dëshmitar, sikurse ju thashë para pushimit  
18 do t'ju bëj disa pyetje lidhur me UÇK-në dhe veprimtarinë e  
19 tyre gjatë kohës që mbërritët jua atje. Edhe do të përdor edhe  
20 ditarin tuaj po edhe ditarin e luftës.

21 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Tani do të doja të shihnim  
22 ditarin tuaj që është me numër 071142 deri në 071313. Dhe  
23 gjermanishtja ka të njëjtin numër. Edhe njëherë për  
24 sekretarinë është materiali 071162. Paragrafi i fundit.

25 PY. Këtu keni thënë më 16 qershor 1999:

1 "UÇK-ja na kishte siguruar që nuk do të kishte asnjë  
2 pengesë prej tyre në kufi dhe gjetkë. Në përgjithësi personat  
3 e UÇK-së bënëin çfarë të donin. Megjithatë deri tani dukej  
4 sikur i kishin mbajtur premtimet e tyre. Gjatë përgatitjeve  
5 udhëheqësit lokalë të UÇK-së janë njohur me ne, komandanti  
6 brigadës flet me ta dhe ju jepen urdhrat."

7 Dëshmitar, keni thënë këtu që UÇK-ja bënte çfarë të  
8 donte. A ju kujtohet ta keni thënë një gjë të tillë:  
9 PË. Po.

10 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Të shohim tani ditarin tjetër  
11 që është me numër 079917 [Sipas përkthimit].

12 PY. Rreshti i fundit:

13 "Në pasdite dy kolegë britanikë dhe dy të UÇK-së vdiqën  
14 duke çminuar një minë."

15 A është e vërtetë pra, që UÇK-ja po e ndihmonte KFOR-in  
16 me heqjen e minave?

17 PË. Nuk mund t'ju them asgjë lidhur me këtë. Ky shënim -- pra  
18 këtë shënim e kam bërë në bazë të një informacioni që më duket  
19 se e kam marrë në brigadë. Nuk kam asgjë më shumë për këtë.  
20 Ose të paktën nuk më kujtohet asgjë më shumë në lidhje me  
21 këtë.

22 PY. Në rregull.

23 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Shohim një shënim tjetër. E  
24 heqim këtë nga ekrani. Shohim --

25 PY. Atëherë fillimisht ju thatë që keni udhëtuar nëpër Kosovë



1 apo jo? Në fund të qershorit i thatë ZPS-së do t'ju jap edhe  
2 referencën për këtë. Është prova materiale P01191.4 - thatë se  
3 në fund të qershorit keni udhëtuar me makinë drejt Prishtinës,  
4 më 30 qershor, më duket. Dhe ju pyetën: A keni pasur ndonjë  
5 komunikim me UÇK-në për shembull gjatë kohës që kalonit përmes  
6 postblloqeve në tyre? Ju u përgjigjët:

7 "Jo, sepse nëse do të kishte postblloqe të UÇK-së ne do  
8 t'i kishim larguar, pra do t'i kishim hequr."

9 A ju kujtohet që keni thënë diçka të tillë?

10 PË. Po.

11 PY. Dhe mbase shpjegimi për këtë gjë gjendet në Pjesën 5,  
12 Pjesën -- pra, më saktë është prova materiale P01191.5, në  
13 faqen 12, dhe keni thënë: Udhëtimi ka qenë në fund të  
14 qershorit dhe po ashtu i thatë ZPS-së që demilitarizimi ishte  
15 në rrugë e sipër asokohe.

16 Ju kujtohet?

17 PË. Po.

18 PY. UÇK-ja [Sipas përkthimit] ju pyeti: Po situata në gusht  
19 si ishte? Dhe e kemi të reflektuar në provën materiale  
20 P01191.4 në faqen 8. Ju keni thënë: Deri në ato -- në atë kohë  
21 UÇK-ja nuk mbante -- nuk kryente më asnjë detyrë, në gusht. Të  
22 gjitha postblloqet dhe patrullat bëheshin nga trupat e NATO-s.

23 A ju kujtohet që e keni thënë këtë?

24 PË. Po.

25 PY. Pra, në thelb ata ju respektonin kërkesat tuaja, dhe kjo

1 thuhet në ditari, a është kështu?

2 PË. Me sa më kujtohet demilitarizimi është kryer pa  
3 problematika madhore.

4 PY. Faleminderit. Dua tani --

5 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Atëherë do të doja tani të  
6 shfaqej sërish ditari me numër 071142 deri në 071313 faqja  
7 071228. 29 qershor 1999 është data. Shohim paragrafin e parë.

8 PY. Keni thënë:

9 "Disa grupe të UÇK-së mbase nuk duan t'i dorëzojnë armët  
10 e tyre. Bashkëpunimi mes KFOR-it dhe UÇK-së është i mirë, por  
11 UÇK-ja nuk është organizatë me udhëheqje qendrore siç mendojnë  
12 disa."

13 Dëshmitar, a mund të na shpjegoni çfarë keni dashur të  
14 thoni me këtë?

15 PË. Ky paragraf gjithashtu është bërë një paragraf që është  
16 shkruar për momentin dhe ajo që kam dashur të them unë është  
17 kjo, që UÇK-ja nuk ishte një organizatë e ngjashme me ushtritë  
18 perëndimore. Ekzistonin grupe të ndryshme brenda UÇK-së dhe  
19 kishte dallime krahinore.

20 PY. Faleminderit.

21 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Në të njëjtin ditari, besoj se  
22 është faqja e radhës, paragrafi i tretë.

23 PY. 30 qershor është data e ditarit. Ju thoni këtu:

24 "UÇK-ja ka hyrë në zonat sipas kalendarit dhe po  
25 respekton marrëveshjen. Udhëheqja e KFOR-it në këtë mënyrë --

1 e sheh në të njëjtën mënyrë edhe ata nuk" - nuk lexohet diçka  
2 - "mbështeten nga komandantët e UÇK-së, po kush del garant për  
3 radikalët?"

4 Çfarë keni dash të thoni me këtë për "radikalët"?

5 PË. Kjo ka qenë pas çlirimit. Kishte persona të  
6 padisiplinuar, anëtarë të UÇK-së të cilët mund të bënin disa  
7 sulme. Këtë kam dashur të them. Që udhëheqja e UÇK-së nuk  
8 ishte në pozicion, dhe ky është mendimi im në fakt për këtë,  
9 nuk ishte në pozicion të kontrollonte çdo person të vetëm në  
10 atë vend.

11 PY. Faleminderit. Tani të flasim për bashkëpunimin. Tani dua  
12 të shohim ditarin e luftës së KFOR-it. Le të shohim disa nga  
13 shënimet e zbardhura në ditar, lidhur me UÇK-në. Këtë do ta  
14 bëjmë shumë shpejt.

15 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Ditari SITF00225902 deri në  
16 SITF005184. Ndërsa gjermanishtja ka numrin SITF002248362 deri  
17 në 00225261. Faqja e parë që dua të shohim është 291 ndërsa në  
18 gjermanisht SITF00225141. Nevojitet numri 181125 që është te  
19 kolona përkatëse. Këtu, po.

20 PY. Shohim këtu, diku nga fundi 18 qershor, sitrep - pra  
21 raporti situacional nga KFOR-i:

22 "Gjatë bisedimeve me figurat e larta muslimane dhe  
23 komandantët e UÇK-së në Dragash të dyja palët në mënyrë  
24 solemne janë pajtuar të mos marrin hak ndaj njëri-tjetrit.

25 Dëshmitar, ju kujtohet kjo?

1 PË. Jo. Unë di vetëm që në këtë Dragash -- në zonën e  
2 Dragashit kishte myslimanë dhe i kushtonim vëmendje të veçantë  
3 kësaj, dhe jo vetëm popullatës myslimane, po me sa di unë ka  
4 pasur dhe goranë atje që janë pjesë e etnisë serbe, dhe kjo  
5 zonë ka qenë me interes të veçantë për ne.

6 PY. Por nëse një nga kolegët tuaj e ka shkruar në ditarin e  
7 luftës, nuk ka arsye për ta kontestuar vërtetësinë apo jo?

8 PË. Këto shënime bazohet në informatat që buronin nga vetë  
9 brigada, që vinin nga vetë brigada dhe pjesë të tjera të KFOR-  
10 it dhe unë ma merr mendja, mua ma merr mendja që ky  
11 informacion siç ndodh zakonisht verifikohet. Ishte krejt  
12 normale të verifikoheshin informatat qoftë për vetë  
13 informacioneve nga zbulimi apo në forma të tjera dhe hidheshin  
14 vetëm informata të verifikuara në ditar.

15 Nëse informacioni nuk verifikohet bëhet një shënim lidhur  
16 me këtë.

17 PY. Në rregull. Faleminderit. Kam edhe dy referenca të tjera  
18 por në të njëjtën faqe.

19 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Në të njëjtin dokumentin është  
20 faqja 285 e këtij dokumenti. Më konkretisht është  
21 SITF002251125 tek gjermanishtja. Kërkoj ndjesë është e njëjta  
22 referencë. Numri që na nevojitet ne është 171040-jun. Është  
23 paragrafi i dytë. Jo, anglishtja ishte në rregull. Shkoni më  
24 lart, ju lutem. Ju lutem tek anglishtja shkojmë më lartë në  
25 faqe.

1 PY. Është shënimi i dytë, ku thuhet:

2 "Raport nga Ops Info:

3 "Zona e SMAC DM7783 dhe Novake DM8083 kryesisht të  
4 braktisura prej serbëve ndonëse se oficeri u UÇK-së Çollaku  
5 është përpjekur ta bindë popullatën serbe që të qëndrojë."

6 Më poshtë thotë:

7 "Refugjatët janë informuar në mënyrë të vazhdueshme se  
8 KFOR-i do që popullata të qëndrojë dhe UÇK-ja ka sinjalizuar  
9 edhe pëlqimin e vet që ata të qëndrojnë."

10 Dëshmitar, a ju kujtohet kjo?

11 PË. Jo.

12 PY. Por ju thatë që do të -- ky informacion është i  
13 verifikuar me përjashtim të rasteve ku bëhej një shënim për  
14 këtë, kështu?

15 PË. Kështu supozoj, po.

16 PY. Tani do të doja të flasim për ngjarjet në ndertën e MUP-  
17 it në datën 18 qershor.

18 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Ndërkohë mund ta hiqni nga  
19 ekrani materialin.

20 PY. I thatë ZPS-së dhe kjo është në material P01191.2 që kur  
21 mbërritët atje ju keni thënë - këto kanë qenë fjalët tuaja,  
22 "ka qenë, gati, gati kaos". A ju kujtohet kjo?

23 PË. Po.

24 PY. Dhe keni thënë në të njëjtën referencë:

25 "Jashtë kishte shumë civilë që ecnin, ecnin rreth burgut

1 dhe kishte dhe shumë kosovarë me armë, me uniforma dhe civilë  
2 të cilët ne i hoqëm, i larguam nga burgu.”

3 A ju kujtohet kjo?

4 PË. Po.

5 PY. Mënyra si janë sjellë personat kur keni shkuar ju, është  
6 shprehur në një material që mban të njëjtën referencë. Ju keni  
7 thënë:

8 “Në përgjithësi trupat i respektonin urdhrat apo kërkesat  
9 tona, në përgjithësi.”

10 A ju kujtohet kjo?

11 PË. Po.

12 PY. Dhe në faqen 36 keni thënë që UÇK-ja u largua, pra e  
13 larguam UÇK-në nga ndërtesa dhe ata u pajtuan me këtë dhe nuk  
14 pati asnjë kontestim prej tyre.

15 A ju kujtohet kjo?

16 PË. Po. Ndërtesa u evakuua relativisht shpejt. Anëtarët e  
17 UÇK-së u larguan, me sa më kujtohet, dhe i çarmatosëm në  
18 mënyrë që të lironim të burgosurit që mbaheshin në mënyrë të  
19 paligjshme dhe të kontrollim ndërtesën. Dhe rezultatet mund  
20 t'i gjeni në ditar.

21 PY. Faleminderit. Po ashtu i keni thënë, i thatë ZPS-së dhe  
22 kjo referenca për këtë është në P00191.3, faqja 36, ju thatë  
23 që çarmatosja e UÇK-së ka shkuar pa incidente. A ju kujtohet  
24 ta keni thënë këtë?

25 PË. Po, në zonën, në ndërtesën e MUP-it, po.

1 PY. Por ne e dimë që keni bërë edhe fotografi të personit që  
2 kishte vdekur, që gjetët atje, kështu?

3 PË. Po. Me urdhër të policisë ushtarake, po.

4 PY. Ju shkuat pasi e kishin marrë, kështu që ju nuk e dini  
5 saktësisht pse e kishin marrë këtë person, apo jo?

6 PË. Sipas asaj që na thanë anëtarët e UÇK-së përballë burgut  
7 të gjithë personat që liruan përfshirë dhe të vdekurin, ishin  
8 ose serbë ose bashkëpunëtorë.

9 PY. Faleminderit. E njihni rreshtin Menzel, Dirk Menzel? A ju  
10 kujtohet ky rreshter?

11 PË. A ka qenë mjeku ushtarak që ekzaminoi personin e vdekur?

12 PY. Jo. Jo më duket se ka qenë një nga oficerët që ka qenë në  
13 atë momente në ndërtesën e MUP-it. Më lejoni t'ua lexoj. Do ju  
14 lexoj atë që ka thënë ai. Do jap edhe referencën ndërkohë  
15 072882, Pjesa 2, faqja 14. I kanë bërë pyetje kur janë këta të  
16 burgosur, dhe ai është përgjigjur kështu:

17 "... sipas deklaratave që kemi marrë atje në terren të  
18 paktën nga popullata vendore, mesa duket ishin policë ose  
19 persona që kishin punuar në administratë për serbët. Këto kanë  
20 qenë deklaratat që kemi marrë atje në terren."

21 Pyetje:

22 "Kush ua dha këto deklarata?"

23 Përgjigje:

24 "Nuk më kujtohet se kush."

25 Pyetje:

1 "Po ju thatë personat e zonët. Çfarë keni dashur të thoni  
2 me këtë?"

3 Ai u përgjigj:

4 "Po, personat që në fakt na ndihmuan në fakt me shërbime  
5 përkthimi atje. E shihni edhe në fotografi që ka grumbullime,  
6 tubime njerëzisht dhe në këto tubime, nga këto tubime merrnim  
7 edhe informata nga këta njerëz. Por këto informacione ishin të  
8 pambështetshme. Por sidoqoftë, disa prej këtyre personave  
9 ishin të gatshëm të flisnin. Disa prej tyre flisnin  
10 gjermanisht dhe këto informata kanë dalë prej turmës."

11 Dhe vijon më tej dhe thotë:

12 "Nga këto turma, nga këta persona ka gjithmonë persona që  
13 janë kuriozë dhe ndonjëherë s'ke nevojë edhe t'i pyesësh se  
14 t'i thonë gjërat vetë."

15 Pyetje:

16 "Por në çfarë gjuhe t'i kanë dhënë këto deklaratat?"

17 Përgjigje:

18 "Me shumë të ngjarë në gjermanisht."

19 Dhe ai qesh pastaj, thotë:

20 "Po, po, kuptohet, pjesërisht, përpiqeshin. Del një lajm  
21 si telefon i prishur dhe qarkullon nga një person tek tjetri  
22 ..."

23 Pyetja që i është bërë atij:

24 "Po ky informacion është informacion i pambështetshëm?"

25 Përgjigja e tij:



1 "Po, po, e sigurt."

2 Pra, ai mendon që informatat kanë marrë që ishin se  
3 personat ishin policë apo persona që punonin në administratë  
4 për serbët ishin informata të pabesueshme se ishin si puna e  
5 telefonit të prishur. A ka qenë ky rasti sipas jush?

6 PË. Kur e dëgjova fjalën "bashkëpunëtor" e kisha pak unë e  
7 bazoja termin "bashkëpunëtor" në ato që merrja nga bisedat me  
8 personat nga UÇK-ja. Disa prej tyre flisnin gjermanisht me  
9 theks zviceran ose austriak.

10 PY. Në fakt realiteti është ky, ju keni shkuar atje pas  
11 ngjarjes dhe ju nuk jeni pjesë -- ju nuk jeni pjesë e UÇK-së  
12 dhe ju nuk e dini kush i mori këta persona, dhe ju nuk e dini  
13 pse janë ndaluar këta persona, apo jo?

14 PË. Unë mund t'ju them ato që kam dëgjuar. Kam dëgjuar që  
15 ishin "bashkëpunëtorë".

16 PY. Kolegu im në fakt më tha që Dirk Menzel ka qenë pjesë e  
17 batalionit të mbrojtjes ajrore. Këtë po e them për  
18 procesverbal.

19 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Tani do të doja që të shfaqim  
20 në ekran provën materiale P00858. Nuk është për publikun.  
21 Shkojmë te faqja 16.

22 PY. Kjo është autopsia nga mjeku. Është autopsia apo raporti  
23 nga autopsia që ka bërë një mjek dhe mund të shihni rezultatet  
24 këtu kur thotë:

25 "Të nxirat që janë konstatuar sipas mendimit tim, nuk

1 përfaqësojnë një lëndim vdekjeprurës. Hapat që janë gjetur  
2 tregojnë që personi ka pasur probleme kardiovaskulare. Në këtë  
3 rast shpjegohet vdekja nga sulmi në zemër.”

4 Në atë kohë e keni parë këtë raport, apo qysh prej asaj  
5 kohe e keni parë ndonjë herë këtë raport?

6 PË. E kam parë raportin. Kam qenë i pranishëm kur mjeku kreu  
7 ekzaminimin. Personi i vdekur ishte i lidhur në një karrige me  
8 pranga -- një dorë e prangosur. Dhe policia ushtarake më tha  
9 ta dokumentoja situatën, i ndjeri -- të ndjerin e çliruan, ja  
10 hoqën prangat edhe e ekzaminoi mjeku Schreckenbauer më duket  
11 se ka qenë emri, po diçka e tillë. Ekzaminoi nga të gjitha  
12 anët e trupit, para, pas dhe mjeku pa të nxira dhe lëndime në  
13 trup. Dhe më kujtohet që ka thënë se që rrahja apo këto  
14 lëndime, në fakt në rrahje dhe lëndime nuk kanë qenë shkak i  
15 vdekjes, por ka të ngjarë të ketë pasur një arrest kardiak që  
16 ka shkaktuar vdekjen. Dhe me shumë të ngjarë ky ishte shkak i  
17 vdekjes së këtij personi.

18 PY. Faleminderit. Nuk kam më pyetje.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

20 Znj. O'Reilly.

21 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Më falni, a mund të paraqes dhe  
22 dokumentet për t'u paraqitur në prova gjyqësore apo duhet ta  
23 bëj këtë në fund?

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem

25 gjithashtu kërkoni që të paraqiten dokumentet në momentin që i

1 përdorni. Mos prisni deri në fund. Kështu që ju lutem bëjeni  
2 tani.

3 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Faleminderit.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

5 O'Reilly, një çast. Uluni, ju lutem.

6 Në rregull. Vazhdojmë me znj. O'Reilly, mblidhni  
7 referencat që keni dhe na i jepni në fund të gjitha, atëherë.

8 Pyetje të palës tjetër nga znj. O'Reilly:

9 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim]

10 PY. Mirëmengjes, Dëshmitar. Quhem Annie O'Reilly dhe do t'ju  
11 bëj disa pyetje në emër të Kadri Veselit.

12 PY. Mirëmengjes.

13 PY. Do të flasim për të njëjtën temë dhe unë fillimisht do të  
14 doja t'ju tregoja disa prej fotografive që më duket se thatë  
15 se i keni bërë ju atë ditë.

16 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Tani fotografia e parë që do të  
17 doja që të shfaqej në ekran është me numër 71934. Është faqja  
18 e parë e dokumentit. Dhe një herë, ju kërkoj ndjesë e dhashë  
19 numrin gabim, tre shifrat e fundit janë 934, jo 394 [Sipas  
20 përkthimit].

21 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dua të  
22 sigurohem që ky informacion të mos përcillet për publikun.

23 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Faleminderit.

24 PY. Dëshmitar, ky është letërnjoftimi i personit të ndjerë  
25 për të cilin po flisnim edhe disa hape të personit që janë

1 gjetur atje. Ju e keni bërë këtë fotografi, apo jo?

2 PY. Sa i takon kësaj fotografie nuk jam 100 për qind i  
3 sigurt.

4 PY. Po a ju kujtohet ta keni parë letërnjoftimin në ndonjë  
5 moment?

6 PË. Po, më kujtohet. Mesa më kujtohet mua letërnjoftimi është  
7 sekuestruar, është marrë, pra. Po, është marrë, po.

8 PY. Faleminderit. Dhe tek kutia me hape që është gjetur tek  
9 viktimat dhe referenca për këtë është --

10 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] SITF00033529 dhe mendoj se kjo  
11 duhet të shfaqet në ekran. Edhe faqja konkrete që na nevojitet  
12 përfundon me 4128.

13 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Edhe ky dokument është  
14 konfidencial.

15 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Faqja 600, ju lutem në PDF.

16 PY. Ky është një raport i hetuesit dhe këtu flet [REDAKTUAR]  
17 [REDAKTUAR]. Dhe thuhet:

18 "Kur e pyetëm për mjekimin që i gjetëm [REDAKTUAR] në  
19 vendngjarje, ai u përgjigj se këto mjekime përdorëshin për  
20 stresin dhe tha se [REDAKTUAR] këto barna i merrte herë pas  
21 here, dhe është një mjekim që jepet normalisht kur një person  
22 ka tensionin e lartë."

23 Dëshmitar, a dini gjë lidhur me këto hape që janë gjetur  
24 tek trupi i personit?

25 PË. Jo, nuk di.

1 PY. Është edhe një faqe tjetër nga raporti i hetimit për të  
2 cilën do të doja të më komentoni nëse është e mundshme.

3 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Është me numër SITF00033529, në  
4 faqen 396 tek versioni në PDF.

5 PY. Shkojmë më poshtë të shohim paragrafin e dytë. Thuhet  
6 kështu. Pra, hetuesi ka shkuar dhe ka folur me farmacistin për  
7 këtë mjekime dhe farmacisti i ka thënë se:

8 "Është një -- jepet vetëm me recetë nga mjeku, mjekimi  
9 merret çdo ditë nëse nuk merret çdo ditë mjekimi i dhënë,  
10 sipas farmacistit mund të shkaktojë arrest kardiak."

11 Dëshmitar, pra, kjo përputhet dhe me atë që ka thënë --  
12 me atë që keni thënë ju në intervistën me ZPS-në që dukej  
13 sikur personi kishte pësuar një arrest kardiak dhe ky ka qenë  
14 shkaku i vdekjes së viktimës. Kështu?

15 PË. Shënimi që kam bërë unë është bazuar në atë që na ka  
16 thënë mjeku. Unë nuk jam mjek.

17 PY. Kështu është. Faleminderit, Dëshmitar. Dhe unë sigurisht  
18 nuk doja që ju të komentoni për diçka që nuk është ekspertiza  
19 juaj. Faleminderit Dëshmitar. Kaq pyetje kisha.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Roberts.

21 Z. ROBERTS: [Përkthim] Edhe katër minuta kanë ngelur.  
22 Doni që të filloj apo do ta bëj pas pushimit.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po sa pyetje  
24 keni?

25 Z. ROBERTS: [Përkthim] Kam 20 minuta, gjysmë ore, po kjo

1 varet edhe nga përgjigjet.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë  
3 pushimin.

4 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Ju kërkoj falje, dhe unë  
5 dëshiroj që të paraqes -- harrova të paraqes faqet që përdora  
6 me dëshmitarin. A ta bëj tani?

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,  
8 gjithmonë kërkon që të pranohen materialet në momentin që i  
9 përdorni. Nuk ka më kuptim të presim deri në fund dhe të kemi  
10 pastaj një larmi të madhe numrash.

11 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Atëherë dokumentat që përdora  
12 unë janë në faqen 600 të dokumentit dhe në faqen 396.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është  
14 materiali SITF0033529?

15 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Po, kështu.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
17 Ka kundërshtime, faqja 396 dhe faqja 600?

18 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Po. Për faqen e parë kemi  
19 kundërshtime dhe mbase do të doja të jepja edhe arsyen për  
20 këtë. Por këtë mund ta bëj pa praninë e dëshmitarit.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jemi duke  
22 filluar pushimin tani. A ka ndonjë gjë kaq të jashtëzakonshme?

23 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Po është një deklaratë e një  
24 dëshmitari tjetër.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po e dimë që

1 është deklaratë e një dëshmitari tjetër. Nuk ka lidhje me këtë  
2 dëshmitari. S'ka pse të dali dëshmitari nga salla. Jepni  
3 kundërshtimin tuaj.

4 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Po. Kundërshtojmë sepse duhen  
5 respektuar kriteret për pranimin e materialeve.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
7 Faleminderit.

8 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Nuk po kërkojmë që të pranohet  
9 për vërtetësinë e përmbajtjes. Thjesht është relevante për  
10 çështjen që po trajtojmë ne. Do të doja të theksoja që doktori  
11 në fakt është pyetur nga Prokuroria dhe -- është pranuar nga  
12 Prokuroria përmes rregullës 153, kështu që ne nuk kemi mundësi  
13 që ta pyesim drejtpërdrejt doktorin në lidhje me këtë.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

15 Znj. Tavakoli keni ndonjë gjë?

16 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Jo, nuk kam asgjë.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, do  
18 të bëjmë gjysmë ore pushim dhe pastaj do të rikthehemi për  
19 pyetjet e tjera. Tani mund të dilni nga salla.

20 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

21 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rikthehemi në  
23 orën 11.30.

24 --- Pauza fillon në orën 10.59

25 --- Seanca rifillon në orën 11.30

1 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dëshiroj që  
2 të korrigjoj procesverbalin sepse reagova shumë më shpejt se  
3 sa ç'duhej më herët. Kështu që dëshiroj që të tërheq  
4 kundërshtimin që kam bërë dhe që është pasqyruar në faqen 600.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Domethënë,  
6 nuk kundërshtoni pranimin e asnjërit prej këtyre faqeve, apo  
7 jo?

8 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Jo, sepse ishte një përmbledhje,  
9 nuk ishte pjesë e një deklarate.

10 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] A mund t'ju paraqes dhe një  
11 herë dokumentet për prova materiale? Ju kërkoj dhe një herë  
12 ndjesë, sa për të filluar.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

14 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Atëherë, së pari është ditari i  
15 këtij dëshmitari. Versioni në gjermanisht -- jo, në anglisht,  
16 është 071142 deri në 071313. Ndërsa versioni në gjermanisht  
17 është me numër 071139 deri në 071313. Dhe faqet janë të njëjta  
18 në të dyja versionet, pra në versionin anglisht dhe në atë në  
19 gjermanisht. Përkatësisht janë 071220, 071190, 07162 [Sipas  
20 përkthimit], 071152, 071170, 071282, 071228 dhe 072229 [Sipas  
21 përkthimit].

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.  
23 Sekretare, a mund t'i pranojmë këto materiale nën një numër  
24 dhe pastaj të kemi nënpjesë për faqet e ndryshme?

25 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,



1 disa faqe të ditarit janë pranuar më herët dje, domethënë janë  
2 pranuar si pjesë e provës materiale P01194. Propozoj që këto  
3 faqe t'i shtohen të njëjtit numri.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, në qoftë  
5 se nuk ka kundërshtime nga palët. Nuk duket sikur ka  
6 kundërshtime nga palët, kështu që nuk ka problem.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dhe klasifikimi është  
8 konfidencial, apo jo?

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ishte mirë  
10 pastaj që të lexohen nënpjesët? Pra secila prej pjesëve do të  
11 marrë një numër tjetër në kuptimin që është prova materiale  
12 pikë 1, 2, 3?

13 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jo, do t'i pranojmë nën  
14 provën materiale që është pranuar më herët.

15 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Dua të pyes në qoftë se,  
16 domethënë është konfidenciale, klasifikimi, apo jo?

17 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Faqet të cilat janë pranuar dje,  
18 duhet të qëndrojnë konfidenciale, ndërkohë që sa i takon  
19 pjesës tjetër nuk kam kundërshtim në qoftë se Avokati dëshiron  
20 që t'i klasifikojë ato si publike.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do jenë pjesë  
22 e një prove materiale kështu që do të marrin të njëjtin  
23 klasifikim. Pra i takon që do të klasifikohen të gjitha si  
24 konfidenciale.

25 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Në rregull.

1 Po ashtu, në ditarin e luftës së KFOR-it versioni në  
2 gjuhën angleze është SITF00225092 deri në SITF00225184,  
3 versioni në gjermanisht është SITF00224836 deri në 00225261.  
4 Faqet janë të njëjtat në versionin në gjermanisht dhe në  
5 anglisht, faqja e parë është 277 dhe në gjermanisht ERN-ja  
6 është SITF00225117. Pastaj është faqja 291 në të dyja  
7 versionet, ndërkohë që ERN-ja në gjermanisht është  
8 SITF00225131. Në fund, është faqja 285 në të dyja versionet.  
9 Ndërkohë që ERN-ja në versionin gjermanishte është  
10 SITF00225125. Faleminderit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
13 faqe të caktuara të të njëjtit dokument janë pranuar dhe si  
14 provë materiale, si 1D00131, dhe propozoj që edhe materialet e  
15 tjera të mund të futen në këtë provë materiale.

16 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Faleminderit.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

18 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Klasifikimi është  
19 konfidencial.

20 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Në të njëjtën mënyrë si më herët,  
21 nuk kundërshtojmë që këto faqe të jenë publike.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

23 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Dëshiroj që të rishikoj provat  
24 materiale përpara se sa të them.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të

1 klasifikohen si publike për procesverbal SITF00033529, faqja  
2 396 dhe faqja 600 pranohen si provë materiale, do të marrin  
3 një numër prove materiale.

4 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
5 faqja 600 me ERN SITF00034128 dhe faqja 396 me ERN SITF0003394  
6 [Sipas përkthimit] nga dokumenti SITF00033529 deri në 00034531  
7 do të marrë numrin e provës materiale 2D00021. Do klasifikohen  
8 si konfidenciale.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
10 Faleminderit.

11 Z. Roberts. E keni fjalën ju. Nuk do t'jua llogarisim  
12 këto pesë minutat e para që humbëm.

13 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.  
14 Do jem më shkurt se ç'kisha planifikuar, gjithsesi, dhe besoj  
15 që do të m'i jepni minutat që do t'i lë pa shfrytëzuar për një  
16 dëshmitar tjetër.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund ta  
18 sillni dëshmitarin në sallë tani, Asistente.

19 [Dëshmitari vijon dëshminë]

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,  
21 tani do fillojmë me pyetjet nga z. Roberts që është Mbrojtja e  
22 z. Selimi.

23 Vazhdoni, z. Roberts.

24 Pyetje të palës tjetër nga z. Roberts:

25 Z. ROBERTS: [Përkthim]

1 PY. Përshëndetje, Dëshmitar. Sikurse e tha dhe Gjykatësi, unë  
2 quhem Geoff Roberts. Unë përfaqësoj z. Selimi dhe kam  
3 pothuajse 20, 30 minuta për t'ju bërë pyetje ju. Megjithatë,  
4 në qoftë se ndonjë pyetjeve të mia nuk është e qartë, ju lutem  
5 ma thoni këtë gjë për t'u munduar për t'jua shtjelluar dhe  
6 t'jua shpjeguar sa më mirë të jetë e qartë. Gjithashtu, do ju  
7 kërkoja që të jepni përgjigje të qarta dhe të drejtpërdrejta  
8 pyetjeve të mia. A është e qartë kjo për ju, Dëshmitar?

9 PË. Po.

10 PY. Shumë shkurtimisht, në përmbledhje ju keni mbërritur më  
11 datë 13 qershor në Kosovë. Për të qenë të qartë, kur KFOR-i ka  
12 mbërritur në Kosovë ata e kishin kuptuar, domethënë, KFOR-i e  
13 kuptonte që kishin autoritet apo kompetencë ekskluzive për  
14 ushtrimin e funksioneve policore. A është e vërtetë kjo,  
15 Dëshmitar?

16 PË. Jo, kjo shkonte përtej detyrave policore apo të drejtave  
17 policore. Sipas rregullave, KFOR-i mendohej që të ndante palët  
18 dhe që të siguronte tërheqjen e forcave jugosllave si edhe të  
19 vendoste rend dhe siguri në Kosovë, përfshirë këtu edhe  
20 çarmatimin e personave të armatosur.

21 PY. Pra, kompetencat e KFOR-it shkonin përtej aktiviteteve  
22 policore, por i përfshinin kompetencat policore, apo jo? Sepse  
23 në momentin që KFOR-i u fut në Kosovë ai ishte autoriteti i  
24 vetëm policor në Kosovë, a është e vërtetë kjo, Dëshmitar?

25 PË. KFOR-i ishte i vetmi autoritet në Kosovë gjatë asaj

1 periudhe, po është e vërtetë kjo.

2 PY. Ju keni pasur njësite policie të policisë ushtarake  
3 brenda KFOR-it, domethënë batalionet e njësitë e ndryshme,  
4 brigadave të KFOR-it që u futën në Kosovë, apo jo, Dëshmitar?

5 PË. Po, Brigada Shumëkombëshe South që e kishte bazën në  
6 Prizren, dhe aty përfshihesha edhe unë, kishte edhe një njësit  
7 që merrej me policinë ushtarake.

8 PY. A ju kujtohet se sa i madh ka qenë njësia e policisë  
9 ushtarake në momentin kur jeni futur për herë të parë në  
10 Kosovë, Dëshmitar?

11 PË. Jo, nuk më kujtohet.

12 PY. Po ka qenë numra të konsiderueshëm?

13 PË. Krahasuar me 5000 vetë që ishte brigada në përgjithësi  
14 besoj që numri i atyre që merreshin me policinë ushtarake  
15 ishte i vogël.

16 PY. Do t'ju lexoj një pjese të asaj që ka thënë një anëtar i  
17 policisë ushtarake gjermane lidhur me përgjegjësitë tuaja.  
18 Bëhet fjalë për personin që quhet Thomas -- Seefeld. A ju  
19 kujtohet, a e njihni Thomas Seefeld? Ju kërkohet ndjesë në qoftë  
20 se nuk e shqiptova siç duhet emrin, por kjo është pyetja e  
21 parë. A e njihni këtë person apo jo?

22 PË. Jo. Ne kemi pasur disa mijëra burra, njerëz, si pjesë të  
23 brigadës tonë. Sigurisht që kam parë shumë fytyra, por nuk  
24 është e thënë që më kujtohen të gjitha. Më kujtohet një numër  
25 shumë i vogël i ushtarëve tanë.

1 PY. E kuptoj këtë gjë. Megjithatë jam më tepër i interesuar  
2 në thelbin apo përmbajtjen e asaj çfarë ka thënë ai më shumë  
3 se sa në faktin se sa e mbani mend personin apo jo. Për  
4 referencë bëhet fjalë për dokumentin ERN 077355-TR-ET, Pjesa  
5 1, e Rishikuar, faqja 4. Ai në përgjithësi pyetet se:

6 "Cilat kanë qenë detyrat dhe përgjegjësitë në gusht të  
7 1999, korrik-gusht 1999?"

8 Ai thotë që:

9 "Ne ishim përgjegjës për vendosjen e rendit dhe sigurisë  
10 në Prizren, por do thoja që pas rënies së Kosovës nuk ka pasur  
11 ndonjë polici operacionale. Kosova nuk kishte polici dhe këto  
12 ishin detyra që na ishin besuar ne. Ne i kemi kryer këto  
13 detyra. Pra, me fjalë të tjera, këto ishin detyrat e caktuara  
14 për ne ndërkohë që më vonë me funksionimin e burgut, pra  
15 kishte edhe funksionim të stacionit policor. Po ashtu janë  
16 bërë edhe patrulla trafiku, kemi kryer gjithashtu edhe detyra  
17 hetimore dhe çfarëdolloj problemi apo çështje tjetër që është  
18 shfaqur."

19 A pajtoheni me këtë çfarë ka thënë ky person, Dëshmitar?  
20 PË. Po, por ka pasur edhe njësi të tjera si për shembull  
21 njësia e mbrojtjes ajrore afër burgut, ka pasur dhe njësi të  
22 tjera të cilat kanë marrë detyrat e policisë. Megjithatë, sa i  
23 takon rolit të policisë ushtarake, detyra që përshkruat ju  
24 ishin detyra që ka kryer policia ushtarake.

25 PY. Nuk ishte vetëm policia ushtarake, por kanë qenë edhe

1 njësitet e tjera të KFOR-it të cilat kanë kryer aktivitete të  
2 ngjashme me ato të policisë në atë kohë, apo jo, Dëshmitar?

3 PË. Ndoshta jo të gjitha njësitë e KFOR-it, por shumë prej  
4 këtyre njësive kanë marrë përsipër këto detyra që ju  
5 përshkruat kurdo që ka qenë e nevojshme. Pra, kjo ishte vetëm  
6 thjesht një pjesë e vogël e detyrave të tyre.

7 PY. A është e drejtë të thuhet se kur anëtarë të UÇK-së gjatë  
8 asaj periudhe janë përpjekur që të kryejnë funksione të  
9 ngjashme me ato të policisë, për shembull që të krijojnë ose  
10 të vendosnin punkte kontrolli, ose aktivitete të tilla të  
11 ngjashme, ju si anëtarë të KFOR-it në mënyrë të menjëhershme e  
12 ndalonit një veprimtari të tillë, sepse kjo ishte pjesa e  
13 përgjegjësive tuaja, apo jo, Dëshmitar?

14 PË. Me aq sa ishte e mundur, ne i kemi ndaluar këto  
15 aktivitete, këto veprimtari shpejt gjatë ditëve të para.

16 PY. Dhe ju ishit shumë të vendosur për ta bërë këtë dhe në  
17 fakt këtë e keni shprehur dhe në provën materiale P191.2, në  
18 faqen 13 dhe 14. Pra keni qenë shumë aktivë dhe shumë të  
19 vendosur për sa i takon përpjekjeve për të ndaluar çdokënd nga  
20 kryerja e veprimtarive të rendit publik sepse këtë e  
21 konsideronit si pjesë të mandatit që ju ishte ngarkuar ju. A  
22 është e vërtetë kjo, Dëshmitar?

23 PË. Nuk kishte kohë për diskutime. Ne thjesht i kryenim  
24 detyrat tona në mënyrë të menjëhershme.

25 PY. Nuk është fare kritikë për juve, por thjesht dua të

1 kuptoj pak më mirë rolin tuaj. Ju e keni parë si pjesë të  
2 rolit tuaj që të ndaloni gjithkënd tjetër që mendohej që të  
3 ushtronte funksionet e rendit publik dhe kur flas për rolin  
4 tuaj, e kam fjalën për rolin e KFOR-it.

5 Për procesverbal, sa për të qenë e qartë, kjo ishte  
6 pyetja për ju, mbase nuk e shpreha siç duhej. Megjithatë më  
7 lejoni ta shpjegoj pak më tepër.

8 Pra, ju e konsideronit si rolin tuaj, pra si rol të KFOR-  
9 it që të ndalonit çdokënd tjetër që kryente funksione të  
10 rendit publik nga kryerja e këtyre funksioneve, e konsideronit  
11 si rolin tuaj, Dëshmitar, apo jo?

12 PË. Po.

13 PY. Mendoj që e keni identifikuar pak më herët kolonelin Rolf  
14 Bescht në qoftë se nuk gabohem, që ka qenë zëvendëskomandant  
15 apo jo, Dëshmitar?

16 PË. Po. E kam identifikuar në një prej fragmenteve të videos  
17 që u shfaqën. Ai ishte zëvendëskomandant i brigadës  
18 shumëkombëshe që ishte e dislokuar në Prizren.

19 PY. Në një artikull të *New York Times* që është prova  
20 materiale P1188.2, dhe është faqja konkrete 013435, ai citohet  
21 të ketë thënë si më poshtë:

22 "... aleatët po marrin kontroll të stacionit të  
23 policisë", dhe këtu e ka fjalën për KFOR-in, "për ta bërë  
24 absolutisht të qartë që ne ishim e vetmja forcë dhe kishim,  
25 ishim të vetmit që kishim autoritet për të vepruar në qytet".



1 Kjo është në përputhje me atë çfarë thoni dhe ju, apo jo,

2 Dëshmitar?

3 PË. Po.

4 PY. Besoj që edhe këtë mesazh ua keni dhënë qartë edhe  
5 ushtarëve të UÇK-së ose komandantëve, ish-komandantëve të UÇK-  
6 së, se ju donit që ky mesazh të transmetohej qartë dhe pa  
7 dyshime, apo jo, Dëshmitar?

8 PË. Personat ushtarakë që kishin përgjegjësi, për shembull  
9 komandanti i brigadës në terren, ata i kanë thënë personave të  
10 UÇK-së lidhur me këtë. Gjenerali Von Korff, komandanti i  
11 brigadës është takuar me persona të UÇK-së disa herë dhe u ka  
12 treguar në mënyrë të qartë se cila do ishte procedura.

13 PY. Për këtë arsye ju ishit të interesuar që ata të  
14 çarmatoseshin sa më shpejt të jetë e mundur dhe të mos mbanin,  
15 të mos kishin kontroll në godina publike apo në pika  
16 kontrolli. Dhe të gjitha këto veprime janë në pajtim me  
17 deklaratën tuaj apo të z. Bescht më mirë, sipas të cilit KFOR-  
18 i gjerman ishte organi i vetëm me autoritet dhe kompetenca në  
19 qytet në atë kohë. A është e drejtë të thuhet kjo, Dëshmitar?

20 PË. Në rajonin e Brigadës Shumëkombëshe, në zonën e  
21 Prizrenit, po. Kjo është e vërtetë për gjermanët, por  
22 gjithashtu edhe për kombet e tjera që ishin të përfaqësuar në  
23 brigadë, që kishim për shembull holandezë.

24 PY. Ndoshta ju nuk e dini këtë gjë, por gjithsesi mendoj që  
25 edhe aspekte të tjera ose njësite të tjera të KFOR-it bënin të

1 njëjtën gjë në zona të tjera e kam fjalën, domethënë kishin të  
2 njëjtën mandat si puna juaq që të merrnin në dorë rendin dhe  
3 sigurinë në Kosovë që prej momentit të futjes së tyre në  
4 Kosovë. A është e drejtë të thuhet kjo, Dëshmitar?

5 PË. Brigada South dhe brigada të tjera kanë vepruar në  
6 përputhje me mandatin që i ishte caktuar atyre.

7 PY. Kur thoni Brigada South, ose Brigada e Jugut, çfarë doni  
8 të thoni, na e shpjegoni pak që ta kuptojmë siç duhet.

9 Domethënë, çfarë fushe ose çfarë zone përfshinte kjo brigadë?

10 PË. Brigada Shumëkombëshe South, ishte një prej disa  
11 brigadave përbërëse të KFOR-it. Dhe kjo ishte një brigadë që  
12 përfshinte jugun e Kosovës, e kishte selinë në Prizren dhe  
13 ishte përgjegjëse për këtë rajon. Me sa di unë, në qoftë se më  
14 kujtohet siç duhet, kishte katër brigada gjithsej KFOR-i.  
15 Megjithatë, ndoshta nuk e mbaj mend siç duhet, nuk jam shumë i  
16 sigurt në qoftë se ishin katër apo jo.

17 Sa i takon Brigadës Shumëkombëshe të Jugut, kjo ishte një  
18 brigadë e cila drejtohej nga gjermanët. Përfshinte gjithashtu  
19 edhe një batalion artilerie holandeze në fillim. Kishim  
20 gjithashtu edhe një njësi të ushtarëve rusë, dhe pastaj pak më  
21 vonë kishte dhe kombe të tjera që u bënë pjesë e brigadës  
22 tonë.

23 PY. Për sa i takon pjesës tjetër të Kosovës, nëse e dini dhe  
24 në qoftë se ju kujtohet, me sa e keni kuptuar ju situatën edhe  
25 njësitë ose brigadat e tjera që funksiononin në pjesë të tjera

1 të Kosovës, kishin njësoj role dhe përgjegjësi si brigada  
2 juaj, apo jo?

3 PË. Po. Udhëheqësia e KFOR-it në Prishtinë mendoj që kishte  
4 katër brigada të cilat kishin detyra identike me ne.

5 PY. Domethënë që të merrnin në dorë rendin dhe sigurinë në  
6 Kosovë, dhe që të ishin organizata ekskluzive për rendin dhe  
7 sigurinë në Kosovë, kështu, Dëshmitar?

8 PË. Në fillim detyra ishte që të shoqëroheshin pjesa e mbetur  
9 e forcave serbe apo jugosllave nga vendi, dhe paralelisht që  
10 të sigurohej rendi dhe siguria në vend ose që të mbahej rendi  
11 dhe siguria në të gjithë Kosovën, në të gjithë territorin e  
12 Kosovës.

13 PY. Si pjesë e përgjegjësive tuaja, ju kishit të drejtë të  
14 ndalonit persona, apo jo? Dhe "ju", e kam fjalën për ushtarët  
15 e KFOR-it gjerman, kanë ndaluar faktikisht persona, apo jo?

16 PË. Ne kemi kapur, kemi ndaluar, shumë persona, dhe për këtë  
17 arsye menjëherë pas çlirimit filluam që të përdornim godinën e  
18 MUP-it si një burg ose vend ndalimi për personat e arrestuar  
19 për plaçkitje apo për akte të tilla të ngjashme, dhe ajo  
20 menaxhohej, domethënë godina e MUP-it menaxhohej nga forcat,  
21 nga njësia e mbrojtjes ajrore.

22 PY. Po nuk ishte menaxhuar nga policia ushtarake? Nga policia  
23 ushtarake e KFOR-it, e kam fjalën.

24 PË. Jam i sigurt që ka qenë e përfshirë edhe policia  
25 ushtarake e KFOR-it, por nuk ka pasur persona të mjaftueshëm

1 për t'u marrë me administrimin e burgut.

2 PY. Besoj që është e saktë që keni thënë në intervistën e  
3 ZPS-së që numri i personave të ndaluar pas datës 20 qershor u  
4 rrit në mënyrë të konsiderueshme deri në -- ose t'jua bëj  
5 ndryshe pyetjen. A e dini ju sa ka qenë numri i përgjithshëm i  
6 personave të ndaluar në atë burg? Sa vetë janë ndaluar aty?

7 PË. Nuk e kam shifrën e saktë, por disa duzina, në qoftë se  
8 jo më shumë se sa njëqind vetë.

9 PY. A e dini se për sa kohë mendonte KFOR-i që mund t'i  
10 mbante të ndaluar personat në këtë burg ose në ambiente ose  
11 godina të tjera ndalimi? E keni idenë e kohës se sa kohë i  
12 mbante KFOR-i këta persona?

13 PË. Nëse më kujtohet siç duhet, mund t'i mbante të ndaluar  
14 deri në tre ditë.

15 PY. Ku e mbështesni këtë njohuri? Ishte kjo pjesë e  
16 procedurave të brendshme të KFOR-it, apo kishte ndonjë bazë  
17 tjetër? Ku e mbështesni, ku mbështetej tjetër kjo periudhë  
18 kohore për mbajtjen të ndaluar të personave?

19 PË. Besoj që KFOR-i ka pas një rregull lidhur me këtë.

20 PY. Po juve nuk ju kujtohet se çfarë rregulli ka qenë ky apo  
21 jo?

22 PË. Jo. Nuk më kujtohet. Ajo çfarë di unë është që pas javëve  
23 apo ditëve të para ka pasur disa zhvillime sa i takon sistemit  
24 të drejtësisë apo forcave të policisë në mënyrë të tillë që  
25 gjërat të çoheshin në drejtimin e duhur.

1 PY. Në rregull. Do kalojmë dhe këtu për pak. Por në fillim  
2 fare, ata ndaloheshin pa pasur ndonjë bazë ose ndonjë themel  
3 për të cilin keni dijeni, domethënë, nuk e dini mbi çfarë baze  
4 ndaloheshin këta njerëzit, apo jo?

5 PË. Nuk mund t'ju them se cila ka qenë baza për këtë.

6 PY. Brenda KFOR-it gjerman kush kishte të drejtë që të  
7 ndalonte dikënd në territorin e Kosovës?

8 PË. Kur kemi parë persona që plaçkisnin dhe i kemi arrestuar  
9 ata, për shembull, kjo ka ndodhur mbështetur në rregullat e  
10 KFOR-it dhe detyrat e KFOR-it që të ndalonte krimet dhe për  
11 këtë arsye, pra kur i kemi parë në veprim e sipër, në  
12 aktivitete kriminale njerëzit, i kemi arrestuar dhe i kemi  
13 ndaluar.

14 PY. A do të thotë kjo që çdokush brenda KFOR-it në qoftë se  
15 shikonte ndonjë gjë të tillë të ndodhte, kishte të drejtë t'i  
16 ndalonte njerëzit dhe a ishte e lejuar kjo mbi bazën e  
17 rregullave të KFOR-it?

18 PË. Le të themi që në pikat e kontrollit ose në patrullimet  
19 në qoftë se kishte probleme, problematika të identifikuar në  
20 qoftë se viheshin re krime që kryheshin, atëherë ushtarët e  
21 patrullimit i arrestonin kryesit e këtyre veprave dhe  
22 siguroheshin që ata të dërgoheshin në burg.

23 PY. Domethënë mund të ishte çdo ushtar brenda KFOR-it  
24 gjerman, nuk ishin detyra këto që ishin të kufizuara vetëm për  
25 anëtarët e policisë ushtarake të KFOR-it, kështu?

1 PË. Brenda urdhrave të tyre mund të ishin mbi, domethënë, kjo  
2 mund të ishte diçka që mund të kryhej nga çdo ushtar i KFOR-  
3 it.

4 PY. Domethënë, çdo ushtar kishte të drejtë që të bënte  
5 arrestime në qoftë se shikonte një aktivitet penal, kështu?  
6 Domethënë nuk është se ishte i kufizuar ndalimi tek një grup i  
7 caktuar ose njësi të caktuar të KFOR-it?

8 PË. Jo, nuk ishte i kufizuar vetëm për njësi të caktuar të  
9 KFOR-it, por çdo ushtar mund të ndalonte dhe të arrestonte një  
10 kryes.

11 PY. Ju besoni që mund të ndalonit dikë deri në tre ditë,  
12 kështu sikur thatë, mbështetur në një urdhër të një komandanti  
13 nëse nuk gabohem, këtë thatë më herët?

14 PË. Mendoj se ne mund t'i mbanim të ndaluar këta persona deri  
15 në tre ditë.

16 PY. Po pastaj çfarë ndodhte mbas këtij afati?

17 PË. Mirë, atëherë filluan të vinin gjykatësit e parë, filluan  
18 të mbërrinin në Kosovë relativisht shpejt. Besoj që të parët  
19 kanë ardhur nga BE-ja. Dhe u krijua një lloj sistemi drejtësie  
20 për të trajtuar këtë çështje. Megjithatë, përveç kësaj varej  
21 shumë se çfarë veprash kishin kryer ata. Për shembull disa  
22 prej tyre janë liruar shumë shpejt në qoftë se ata nuk  
23 përbënin rrezik për njerëzit ose për KFOR-in.

24 PY. Do kalojmë tek data e krijimit të sistemit të drejtësisë,  
25 megjithatë, në qershor dhe korrik nuk ka pasur sistem

1 drejtësie që funksiononte në Kosovë, ishte vetëm KFOR-i që

2 funksiononte atje, a është e vërtetë kjo dëshmitar?

3 PË. Po, është e vërtetë. Megjithatë, organet e para gjyqësore

4 ose përfaqësuesit e parë të drejtësisë mbërritën relativisht

5 shpejt në mënyrë të tillë që t'i jepnin ndihmën e tyre për

6 krijimin e një sistemi efektiv drejtësie.

7 PY. Të kalojmë pak te ditari juaj në mënyrë të tillë që të

8 shikojmë proceset në mënyrën se si i keni kuptuar ju këto

9 procese.

10 Z. ROBERTS: [Përkthim] Më lejoni një çast të gjej numrin

11 ERN. Atëherë, është ERN 071142 deri në 071313-ET, e rishikuar.

12 Do kërkoja konkretisht që të shohim faqen 071266, në të dyja

13 versionet, gjermanisht dhe në anglisht. Do i kërkoja

14 Sekretares që të paraqiste në ekran këtë dokument. Besoj që

15 mund të transmetohet për publikun. Atëherë, dua të paraqitet

16 dhe një herë faqja 071266.

17 Përpara se sa të filloja të lexoja, kishim faqen e duhur

18 në ekran. Kaloni pak më poshtë në faqe ju lutem, 266. Kjo

19 është faqja e duhur.

20 PY. Tek paragrafi i dytë, nga fundi, në anglisht, do ta

21 lexoj:

22 "Ne jemi afër 'monumentit'. Masat e sigurisë në qytetin e

23 vjetër janë forcuar. Ka 65 të burgosur në burg duke përfshirë

24 këtu dhe një grua. Asnjëri prej tyre nuk janë peshq të vegjël.

25 Komandanti i brigadës ka këshilluar, i këshilluar nga

1 këshilltari ligjor vendosi sa i takon kohës së qëndrimit në  
2 burg, ose kohës së ndalimit”.

3 A e shikon këtë, Dëshmitar?

4 PË. Kjo më ndihmon që të kujtoj. Po, sa i takon kontingjentit  
5 gjerman ne kishim dhe një këshilltar juridik që ishte kolonel,  
6 zëvendës-kolonel. Ky ishte një rol i vazhdueshëm i tij sepse  
7 ai më këshillonte komandën sa i takon çështjeve ligjore. Dhe  
8 ky është personi i cili është marrë edhe lidhur me këtë  
9 çështje, domethënë, kohëzgjatjen e ndalimit.

10 PY. Pra, sipas ditarit tuaj, është komandant i brigadës që  
11 vendos në qoftë se një person mbahet në paraburgim apo jo.

12 PË. Po. Këshilltari ligjor është këshilltar. Vendimi i  
13 komandantit ushtarak bazohej pikërisht në këtë.

14 PY. Kush vendoste nëse personi mbahej i ndaluar? Ishte  
15 komandanti i brigadës që e bënte këtë sipas ditarit tuaj, apo  
16 jo?

17 PË. Po.

18 PY. Dhe ai mund të vendoste që të zgjaste masën e ndalimit në  
19 qoftë se e konsideronte këtë të arsyeshme?

20 PË. Me sa më kujtohet kështu ka ndodhur.

21 PY. Dhe më 7 korrik, pra në kohën që po flasim, nuk ka patur  
22 proces gjyqësor që funksiononte për individët që kishin  
23 mundësi, këta individë të ndaluar që të kundërshtonin masën e  
24 ndalimit?

25 PË. Mendoj që në atë kohë nuk ka patur gjykatës civilë të



1 pranishëm që mund të vepronin bazuar në ligjet civile.

2 PY. Po përpiqem të kuptoj atë që keni bërë ju, domethënë kur  
3 keni mbajtur persona të caktuar të ndaluar nuk keni patur  
4 proces gjyqësor për të vendosur nëse do të vazhdonit t'i  
5 mbanit të ndaluar. Kishit një vendim nga komandanti i brigadës  
6 dhe kjo ishte mënyra se si organi ushtarak funksiononte. Pra,  
7 nuk po ju kritikoj, është, thjesht po përpiqem të kuptoj se si  
8 kanë funksionuar këto vendime, si janë marrë këto vendime.

9 PË. Me sa më kujtohet kështu ka ndodhur për të gjithë KFOR-in  
10 sepse nuk kishte autoritete gjyqësore që ishin funksionale apo  
11 që ishin, që mund të vepronin.

12 PY. Pra, gjithë KFOR-i kishin mundësi të mbanin persona të  
13 caktuar të ndaluar deri në momentin kur merrej vendim për  
14 kohën që ishte vendosur nga komandanti i brigadës. Dhe  
15 komandanti i brigadës mund të zgjaste këtë masë ndalimi. Dhe  
16 kjo ishte normale, apo jo?

17 PË. Të paktën me sa më kujtohet, kështu ka qenë. Të paktën  
18 javët e para.

19 PY. Mendimi im është që kjo ka zgjatur shumë më shumë se kaq  
20 për sa i përket mundësisë reale, pra, që UNMIK-u që të  
21 vendoste ose të krijojë një sistem të drejtësisë që dhe që  
22 KFOR-i të vazhdojë të mbajë persona të caktuar të ndaluar në  
23 qershor në korrik pa ndonjë proces të caktuar dhe pa mundësinë  
24 e personave të ndaluar që të kundërshtojnë këtë masë. Është  
25 kjo, përputhet kjo me mënyrën se si e kuptoni ju?

1 PË. Më kujtohet se përpara që të kthehesha në shtëpi në  
2 fillim të gushtit, ishte një gjykatës gjerman që jetonte në  
3 kampin tonë dhe pastaj ai ka trajtuar çështje të tilla, dhe  
4 kjo duhet të ketë qenë në qershor, më së fundi, qershor. Deri  
5 momenti, pra, kur Gjykatësi ka marrë shërbimin e tij, në emër  
6 të Bashkimit Evropian.

7 PY. Në rregull. Pra, ajo që po thoni ju është që prania e  
8 Gjykatësit aty ka ardhur vetëm në fillim të gushtit i cili  
9 pastaj kishte mundësi të vlerësonte ligjshmërinë e mbajtjes në  
10 ndalim të personave të caktuar nga KFOR-i, është kështu?

11 PË. Po. Besoj që po. Në atë moment, filloi krijimi i policisë  
12 së Kosovës me gjyqësorin, dhe ky Gjykatës ishte duke vepruar  
13 tashmë në një moment në kohë në muajin korrik.

14 PY. Pra, në një moment të caktua në korrik, thoni, unë do të  
15 thoja që është në fund të korrikut që ka ndodhur kjo, por ajo  
16 që po përpiqem të them është që deri në momentin kur KFOR-i  
17 mbante individë të caktuar të ndaluar ata nuk kishin të  
18 drejtën, këta të ndaluarit pra, që të kundërshtonin këtë  
19 ndalim përpara një gjykatësi. E pranoni këtë apo jo?

20 PË. Me sa di unë, kështu është, nuk ka patur gjykatës, nuk ka  
21 patur gjykatës as prokurorë.

22 PY. Dhe mënyra se si ju kuptoni procedurat që ndiqeshin në  
23 burg me policinë ushtarake është që nuk ka patur mundësi  
24 proces të mundshëm që personat e ndaluar të kundërshtonin  
25 masën e ndalimit të tyre, s'ka patur avokat mbrojtës për

1 shembull që të shpreheshin dhe të përfaqësonin këta individë  
2 përpara gjykatësve?

3 PË. Shembulli i ish-ndërtesës së MUP-it aty ishte një  
4 komandant i kompanisë së mbrojtjes ajrore, i cili ishte shef i  
5 burgut dhe ka vepruar si gjykatës hetues ndaj një personi. Dhe  
6 një mashkull përveç një femre me sa më, me sa e di, ata që  
7 janë mbajtur të ndaluar i ka marrë, i ka intervistuar. Kjo nuk  
8 do të thotë që të gjithë janë mbajtur të ndaluar me ditë të  
9 tëra.

10 PY. Jo, nuk -- por ka patur njerëz që janë mbajtur të ndaluar  
11 për ditë të tëra pa patur mundësinë që të ketë një përfaqësim  
12 ligjor pa patur mundësinë që të sillen përpara një Gjykatësi  
13 dhe pa patur mundësinë që të bëjnë apel ndaj ndonjë vendimi që  
14 i mbante ata të ndaluar. Kjo është realiteti i gjendjes me të  
15 cilën ju përballëshit në atë kohë.

16 PË. Është e vështirë të themi një gjë të tillë. Për shkak të  
17 situatës mund të ketë qenë e mundur, por nuk mund ta them me  
18 hollësi, nuk mund ta vlerësoj këtë në hollësi.

19 PY. Do të doja të kalonim në seancë private lidhur me një  
20 dokument në veçanti, i nderuar Gjykatës.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kalojmë në  
22 seancë private.

23 [Seancë private]

24 [Seancë private teksti i fshirë]

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Johan Fritsch (Vijon) (Seancë private)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Roberts

Faqe 69

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18 [Seancë e hapur]

19 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të

21 vazhdoni z. Baiesu.

22 Z. BAIESU: [Përkthim] Faleminderit, z. Gjykatës.

23 PY. Përsëris pyetjen, ju u përgjigjët -- që ta kemi të qartë

24 në procesverbal. Ju nuk e keni parë, nuk keni parë dikë të

25 përdorë këto instrumente për të keqtrajtuar ndonjë nga ata



Dëshmitari: Johan Fritsch (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Baiesu:

Faqe 73

1 individë?

2 PË. Kështu është.

3 PY. Përgjigjja juaj a keni qenë ju i pranishëm, keni parë që  
4 këto instrumente të përdoren për të keqtrajtuar individë që  
5 ishin në ndërtesën e MUP-it?

6 PË. Jo, askush nga KFOR-i nuk ka qenë i pranishëm. KFOR-i e  
7 liroi këtë burg apo të burgosurit.

8 PY. Pra, kur ju dëshmuat se UÇK-ja ka përdorur të njëjtat  
9 instrumente pas largimit të MUP-it keni bërë supozim kur keni  
10 thënë këtë.

11 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kundërshtim. Kjo keqinterpreton  
12 dëshminë e dëshmitarit.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.

14 Dëshmitari mund t'i përgjigjet pyetjes.

15 DËSHMITARI: [Përkthim] Unë kam bërë fotografi të këtyre  
16 instrumenteve, mjeteve, dhe ky shënimi poshtë fotografisë  
17 është shtuar, e kam shtuar unë në ditarin tim. Ne gjetëm këto  
18 sende, mjete, instrumente, mes gjërave të tjera, shkopinj  
19 druri, në mënyrë që mund të ishin përdorur në çdo moment në  
20 kohë. Nuk ishin të fshehura, apo të sistemuara diku, por ishin  
21 diku të gatshme për përdorim.

22 Z. BAIESU: [Përkthim]

23 PY. Siç e thatë ju, mund të ishin përdorur në çdo moment në  
24 kohë dhe mund të jenë përdorur në çdo moment. E keni shënuar  
25 aty në ditarin tuaj, poshtë fotografisë:

1 "Mjetet e torturës nuk kanë ndryshuar".

2 Keni shënuar këtë gjë. Por pyetja ime është, personalisht  
3 juve, nuk keni ndonjë provë që këto instrumente janë përdorur  
4 nga UÇK-ja?

5 PË. Ky shënim sipas fjalorit tim pasqyron përshtypjen që unë  
6 kisha, tani a janë përdorur këto nga UÇK-ja apo jo më parë,  
7 natyrisht nuk mund ta vërtetoj këtë, dhe nuk mund të jap  
8 informacione më konkrete lidhur me këtë.

9 Z. BAIESU: [Përkthim] Këto ishin pyetjet e mia.

10 PY. Faleminderit, Dëshmitar.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,  
12 z. Baiesu.

13 Ka ndonjë pyetje nga ana e Prokurorisë?

14 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Nuk kemi pyetje.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi  
16 Barthe.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi  
18 Smith.

19 Pyetje nga Trupi Gjykses:

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Mirëdita, z. Dëshmitar. Uroj  
21 të më dëgjoni mirë dhe qartë.

22 Anëtarët e Trupit Gjykses kanë disa pyetje të tjera  
23 shtesë, të cilat ne mendojmë janë të nevojshme të kuptojmë në  
24 tërësi deklaratën tuaj, pyetjet e mia të para kanë të bëjnë me  
25 gjendjen e sigurisë në jug të Kosovës në verë të 1999, që

1 është koha e dislokimit tuaj në atë pjesë.

2 Në deklaratën tuaj me ZPS-në, në shtator të 2019, keni  
3 thënë dhe kjo është Pjesa 4 e transkriptit të intervistës suaj  
4 dhënë ZPS-së, faqja 2, rreshti 15-16. Dh epo citoj:

5 "Ajo që ne nuk mund të parandalonim ishin vrasjet e  
6 herëpashershme në sektorin të serbëve, meshkujve, familjeve.  
7 Dhe kjo ka ndodhur ditët e para. Nuk mund ta ndalonit këtë  
8 gjë".

9 Dhe pjesa tjetër që do të citoj është në Pjesën 4, faqet  
10 2, rreshti 21-22, ku ju thoni:

11 "... ka patur veprime dhune, plaçkitje..."

12 Dhe kjo është nga Pjesa 4, faqja 2, rreshti 1 deri në  
13 rreshtin 3. Dhe ju thoni pastaj që:

14 "... të paktën në një rast uji është ndërprerë dhe  
15 zjarrfikësit nuk kishin mundësi që ta përdornin."

16 Pra, pyetje ime është. Ju duhet të merreshit me  
17 zjarrvënie, vrasje që ndodhnin në raste të caktuara, akte të  
18 tjera dhune, bëhet fjalë pra për ditët e para të arritjes suaj  
19 në Kosovë?

20 PË. Po.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Çfarë roli luajti UÇK-ja  
22 lidhur me këtë pikë, në qoftë se ka luajtur ndonjë rol? Më  
23 duket që keni thënë në intervistën e dhënë ZPS-së edhe më  
24 herët sot se ata po bënë, po patrullonin në qytetin e  
25 Prizrenit dhe kishin vendosur pika kontrolli në rrugë.

1 PË. Po. Dhe kishte prani më të madhe në lagjet serbe, me  
2 qëllim të parandalimit të akteve të hakmarrjes.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Një sekondë, ju lutem. Po  
4 pres që transkripti të jetë i plotë.

5 Ju sapo thatë "një prani më e madhe", apo "kishte prani  
6 më të madhe në lagjet serbe me qëllim që të parandaloheshin  
7 veprimet e hakmarrjes". E keni fjalën për UÇK-në që kishte  
8 prani më të madhe në lagjet serbe nga popullsia për të  
9 parandaluar veprime hakmarrjeje? Është kjo që po thoni?

10 PË. Jo, kur flas për "prani" e kam fjalën për forcat e KFOR-  
11 it.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] E kuptoj. Dëshmitar, ju  
13 personalisht a keni parë pika kontrolli të UÇK-së? Postblloqe?

14 PË. Në periudhën 13, 14 qershor, momenti i hyrjes sonë, unë  
15 pashë postbllokun e parë të UÇK-së në pikën e kalimit kufitar  
16 në Morinë, që është me Shqipërinë. Dhe kjo ishte menjëherë pas  
17 tërheqjes së forcave serbe. UÇK-ja mori kontrollin e pikës së  
18 kalimit kufitar. Kjo është diçka që ne e parandaluam shumë  
19 shpejt, e ndaluam. Dhe në ditët në vijim ajo që ndaluam po  
20 ashtu ishin postblloqet e paligjshme të UÇK-së, forcave të  
21 UÇK-së. Dhe pjesërisht ishin edhe njerëz me rroba civile që  
22 shiheshin aty.

23 Këto ishin postblloqe të paligjshme, UÇK-ja nuk kishte  
24 autoritet që të ushtronte pushtet në asnjë formë.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Si i keni dalluar ju apo si

1 e keni ditur që këto ishin postblloqe të UÇK-së? A ishin  
2 ushtarët të veshur me uniforma të UÇK-së apo ju kanë thënë ata  
3 që i përkisnin, ishin pjesëtarë të UÇK-së? A keni kontrolluar  
4 letërnjoftimet e tyre? Si e keni kuptuar këtë?  
5 PË. Ajo që ishte shpërndarë gjerësisht, gjë që dihej mes  
6 pjesëtarëve të UÇK-së ishte e përdorur gjerësisht, ishte  
7 emblema e UÇK-së. Dhe shumë shpesh, në fakt jo aq shpesh, por  
8 ajo që ishte e dukshme ishte shenja. Ishte një shirit në krah  
9 që tregonte se ishin një lloj policie ushtarake. Dhe kjo ka  
10 qenë e qartë të paktën për, shenjë e qartë që ishin pjesëtarë  
11 të UÇK-së.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Personat që ju mendonit  
13 ishin pjesëtarë të UÇK-së, a ju shpjeguan ata juve se pse i  
14 kishin vënë këto postblloqe në pikën e kalimit kufitar, për  
15 shembull me Shqipërinë? A keni biseduar ju me këta njerëz?  
16 PË. Kjo ka qenë periudhë shumë e vështirë, dhe në qoftë se  
17 kishte nevojë të bëheshin bisedime në këtë periudhë të  
18 tensionuar dhe të vështirë kjo ka ndodhur mes udhëheqësve  
19 ushtarakë të UÇK-së. Dhe udhëheqësit ushtarakë kanë biseduar  
20 me udhëheqësit e UÇK-së me qëllim që të garantonin një proces  
21 të qetë dhe që ndiqte një rend të caktuar.

22 Pse kjo UÇK-ja ka krijuar këto pika kontrolli, apo  
23 postblloqe, dhe pse kanë marrur kontrollin e pikës së kalimit  
24 në kufi nuk ishte e rëndësishme për ne.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Tani dua të

1 flasim për ngjarjet në ish-ndërtesën e MUP-in më 18 qershor  
2 1999, dhe do të doja të filloj me pyetjen: A mund të na thoni  
3 ne sa ushtarë të UÇK-së ishin aty të pranishëm kur ju arritët  
4 aty? Përafërsisht, natyrisht.

5 PË. Më shumë se sa dhjetë. Rreth 20 mendoj, fillimisht në  
6 burg. Dhe gjatë aksionit që u ndërmor, erdhën edhe njerëz të  
7 tjerë gjithnjë e më shumë, përfshirë edhe pjesëtarë të UÇK-së,  
8 dhe kjo ishte në mes të qytetit. Dhe kishte dhe pjesëtarë të  
9 shtypit, shtypit ndërkombëtar. Dhe po ashtu forca të tjera  
10 shtesë nga KFOR-i, personeli ushtarak, personel mjekësor,  
11 erdhën aty.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në deklaratën tuaj dhënë  
13 ZPS-së, i referohem këtu pjesës 3, faqes 7, rreshti 5-11,  
14 thatë që forcat tuaja të para ishin të pranishme në vend aty,  
15 aty ishin disa pjesëtarë të UÇK-së që po ecnin, silleshin aty,  
16 të veshur me uniformë dhe se disa prej tyre përpiqeshin që  
17 t'jua vështirësonin incizimin ngjarjes aty. Ju kujtohet që e  
18 keni thënë këtë në intervistën e ZPS-së, që të paktën me  
19 pjesën e fundit kur njerëzit përpiqeshin ta bënin të vështirë  
20 për ata që po incizonin apo regjistronin ngjarjen?

21 PË. Po. Ky problem u zgjidh relativisht shpejt.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A mund të na thoni këta  
23 persona çfarë bënë konkretisht që të parandalonin ose të  
24 bllokonin regjistrimin apo incizimin apo ta bënin të vështirë?

25 PË. Gjëra të zakonshme që dihen nga media: Duke vënë duart

1 përpara kamerës, apo duke thënë "jo, jo" në gjuhën e tyre. Po  
2 ky problem besoj që u zgjodh relativisht shpejt nga ndërhyrja  
3 jonë. Nuk ishte problem i madh.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A mund të përshkruani  
5 uniformën e këtyre personave, personat që po, që ishin,  
6 shprehnin pakënaqësi, apo ishin kundër incizimit? Për shembull  
7 ngjyra e uniformave, si ishte?

8 PË. Nuk mund të them asgjë për, lidhur me vështirësitë që  
9 ishte, që u paraqiteshin personave që përpiqeshin t'i  
10 incizonin skenat, nuk mund të them asgjë për uniformat. Ishte  
11 fotografi e zakonshme e uniformave të zeza, uniformat e  
12 përziera deri tek uniformat ushtarake apo civile.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Nuk ka përkthim]

14 PË. Uniformat dhe emblemat e bënin të qartë që ata ishin  
15 anëtarë të UÇK-së. Ka qenë më së paku një anëtar i UÇK-së që e  
16 kishte uniformën të plotë, dhe gjestet e tij, sjellja e tij, e  
17 bënin të qartë që ky personi ishte shef, ishte komandant.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A biseduat me këtë person?

19 PË. Jo, nuk bisedova me të.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po a ju tha ai ju  
21 shprehimisht, ai apo ajo, a ju tha shprehimisht që unë jam  
22 anëtar i UÇK-së?

23 PË. Me sa di unë, ky person kishte uniformë të plotë. Nuk e  
24 di e cilës kombësi ishte, por ka pas fotografi në shtyp. Dhe  
25 më duket se në kokë kishte simbolin e UÇK-së. Dhe nga mënyra

1 se si sillej, ishte e qartë që ishte drejtues.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Nuk ishte kjo pyetje ime.

3 Unë ju pyeta, a ua tha shprehimisht personi që ishte anëtar i  
4 UÇK-së?

5 PË. Jo.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A ju tha ndonjë person ju që  
7 ky person nuk ishte i UÇK-së, nga jashtë ndërtesës së MUP-it,  
8 ua tha njeri, jashtë edhe brenda ndërtesës së MUP-it, ju tha  
9 ju njeri që ky person ishte i UÇK-së?

10 PË. Jo. Po, dukej qartë që ishin pjesë të këtij informacioni.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, ju nuk kishit asnjë  
12 dyshim që personat që kishin shkuar pra që qëndronin në  
13 ndërtesën e MUP-it ishin anëtarë të UÇK-së, apo jo?

14 PË. Nuk kisha absolutisht asnjë dyshim.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dëshmitar, a keni parë apo  
16 keni dëgjuar gjë për personat që ishin rrëmbyer dhe mbajtur të  
17 ndaluar nga persona nga Shqipëria apo nga vende të tjera dhe  
18 që kishin blerë uniforma apo kishin uniformat e UÇK-së dhe  
19 pretendonin se ishin të UÇK-së?

20 PË. Jo.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po a e keni dëgjuar gjë për  
22 persona që ishin arrestuar apo ishin ndaluar nga disa individë  
23 që pretendonin se ishin të UÇK-së dhe që vishnin, që mbanin  
24 uniforma të UÇK-së, pra që pretendonin se ishin të UÇK-së?

25 PË. Jo, absolutisht jo.



1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe a ju ka dorëzuar UÇK-ja  
2 ju, pra, KFOR-it, ndonjë person a ju ka dhënë emra personash,  
3 që dyshohej se kishin kryer vepra penale, qofshin në cilësinë  
4 e të dyshuarit nga vetë rangjet e UÇK-së apo persona të tjerë  
5 që nuk ishin pjesë e UÇK-së? Me sa keni ju në dijeni, a ka  
6 ndodhur kjo?

7 PË. Nuk më kujtohet të ketë ndodhur diçka e tillë.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dëshmitar, tani dua të  
9 flasim për personat që u liruan nga ish-ndërtesa e MUP-it më  
10 18 qershor të 1999. Ju lutem, a mund të na përshkruani  
11 gjendjen e tyre fizike dhe mendore, a kishin lëndime të  
12 dukshme? Dhe nëse kishin lëndime, të cilit lloj ishin këto?

13 PË. Siç mund ta shihnit në fotografitë e mia, disa burra  
14 kishin të nxira të mëdha, në bark, në shpinë, edhe në pjesë të  
15 tjera të trupit. Na i treguan këto të nxira, mavijosje, pra,  
16 dhe unë i dokumentova ato dhe kjo ka ndodhur shkurtimisht pasi  
17 i liruam. Ekipi ynë mjekësor i mjekoi përpara godinës ndërsa  
18 ndërkohë forcat e tjera tonat spastronin ndërtesën.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A patë plagë të shkaktuara  
20 prej thikës?

21 PË. Jo.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Këta persona, pra personat  
23 që u liruan prej jush, dhe kolegëve tuaj, a ishin të lodhur, a  
24 ishin të shqetësuar? Ju kujtohet?

25 PË. Ishin të gëzuar që u liruan, por po vuanin. Po vuanin

1 mendërisht dhe fizikisht.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A kërkuan ndonjë gjë këta  
3 persona, a kërkuan ujë, kërkuan ushqim?

4 PË. Nuk e di a kanë kërkuar diçka të tillë, por ne menjëherë  
5 u dhamë ujë, edhe ekipi mjekësor bëri ekzaminimet përkatëse.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A kërkuan që të kontaktoni  
7 me të afërmit e tyre?

8 PË. Nuk më kujtohet.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në intervistën për ZPS-në,  
10 por edhe sot, thatë se keni dëgjuar prej personave të UÇK-së  
11 që të burgosurit në ndërtesën e MUP-it pretendohet se ishin  
12 bashkëpunëtorë, kështu?

13 PË. Po.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Tani, do ju lutesha të na  
15 ndihmonit me kohën e saktë kur ka ndodhur ngjarja, do fillojmë  
16 me ndërtesën e MUP-it. Fillimisht, bastisja ka ndodhur më 18  
17 qershor të 1999, kështu?

18 PË. Kështu.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Serbët ishin larguar nga  
20 zona disa ditë më përpara, saktë?

21 PË. Po, disa ditë para bastisjes.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Keni ndonjë informacion kur  
23 e mori në kontroll UÇK-ja ndërtesën e MUP-it, a ka qenë 12  
24 qershor, 13 qershor, 14, 15, a më vonë?

25 PË. Jo, nuk kam informacion.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dëshmitar, folëm për  
2 ngjarjet në ish-ndërtesën e MUP-it. Por a keni dijeni për  
3 vende të tjera ndalimi që përdorte UÇK-ja me përjashtim të  
4 ndërtesës së MUP-it?

5 PË. Jo. Nuk më kujtohet asgjë e kësaj natyre. Unë kam dhënë  
6 ndihmë për lirim të një personi në ambientet e një fabrike  
7 jashtë qytetit, por ky s'ishte burg, ishte një person i vetëm.  
8 Një individ. Sa i takon vendeve të tjera, ku të kishte më  
9 shumë se një person të ndaluar, nuk mund t'ju them asgjë sepse  
10 nuk më kujtohet gjë.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në rregull. Në intervistën  
12 për ZPS-në në faqet 1 deri në 5, keni përmendur një ngjarje,  
13 një rast, ku u përdor një tank për të hapur -- për të hyrë  
14 pra, në një fabrikë për të hapur derën e një fabrike. Ky ka  
15 qenë ai incidenti që përmendët ju kur thatë që liruam një  
16 individ?

17 PË. Po, ky rast.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe kjo ka qenë një fabrikë  
19 në Krushën e Madhe, sipas asaj që keni thënë në Pjesën 5 të  
20 intervistës për ZPS-në, kështu?

21 PË. Në ditar e kam dhe emrin e vendit, ne morëm informacion  
22 në lidhje me këtë dhe shkua në vendngjarje, mirëpo dera e  
23 fabrikës ishte e mbyllur kështu që na u desh të përdornim  
24 tankun për të hyrë.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Me sa ju kujtohet, kjo ka

1 qenë para apo pas rastit në ndërtesën e MUP-it?

2 PË. Më pas.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po nga e dinit ju që kjo  
4 fabrikë përdorej nga UÇK-ja? Nga e dinit ju këtë?

5 PË. Merrnim informacione të caktuara nga banorët e zonës, dhe  
6 në bazë të informacioneve gjenim varre apo gjenim vendngjarje.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A keni takuar ju, a takuat  
8 ju persona që kishin uniforma të UÇK-së tek ai vendi?

9 PË. Nuk jam më i sigurt për këtë. Nuk e di nëse personat, nuk  
10 e di nëse ata personat që po e mbanin këtë individ të burgosur  
11 kishin apo nuk kishin uniforma, nuk më kujtohet.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Unë po ju pyes sepse do të  
13 doja të dija, a e kishit të qartë ju në atë kohë që ky ishte  
14 një vend ndalimi që përdorej nga UÇK-ja apo ishte një incident  
15 i izoluar me të cilin nuk kishte fare lidhje UÇK-ja?

16 PË. Më kujtohet kur morëm këtë informacionin, na thanë që po  
17 mbajnë një person të ndaluar në këtë objekt, ne shkuam shumë  
18 shpejt atje, e liruan këtë person, burrin. Dhe më pas unë  
19 shkova menjëherë të kryeja detyrën e radhës. Prandaj nuk mund  
20 t'ju them shumë në lidhje me pengmarrësit, kush ishin  
21 pengmarrësit.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Po në pjesën 5  
23 të intervistës me ZPS-në, ju keni përmendur një rast tjetër,  
24 në kohë, një fshat i vogël serb që quhej Dojnicë ishte  
25 shkatërruar dhe aty keni gjetur trupat e pesë a gjashtë

1 personave në moshë të thyer të cilët ishin vrarë dhe nuk ishin  
2 larguar nga fshati. Por në intervistë ama keni thënë se nuk ka  
3 pasur ndonjë indikacion apo ndonjë tregues që të ketë qenë e  
4 pranishme UÇK-ja në këtë zonë, kështu? Ju kujtohet t'ia keni  
5 thënë këtë fillimisht ZPS-së?

6 PË. Po. Por do të doja të thoja diçka më shumë lidhur me  
7 Dojnicën, i nderuar Gjykatës.

8 Morëm një informacion në bazë të të cilit kishte ndodhur  
9 diçka në pjesën jugore të zonës tonë, Maja e Dragashit. Na  
10 thanë që është një vend atje, në një vend të caktuar është  
11 kryer një krim.

12 Ne shkua në këtë zonë malore shumë të izoluar, dhe atje  
13 gjetëm një fshat. Pyetëm personat e fshatit lidhur me atë që  
14 kishim dëgjuar dhe ka qenë hera e parë në tërë këto javë kur  
15 nuk na ka mbështetur popullata shqiptare, nuk pranuan të na  
16 ndihmonin. E mbajtën gojën mbyllur. Ne vazhduam e vazhduam më  
17 tej në mal, dhe gjetëm këtë fshatin Dojnicë.

18 E raportuam këtë sigurisht dhe morën forcat e tjera  
19 detyrën dhe ne u kthyem. Kryesit nuk i gjetëm. E vetmja gjë që  
20 kemi gjetur ka qenë vendngjarja e krimit. Dhe veç kësaj pamë  
21 dhe që ishte një kishë ortodokse serbe që e kishin  
22 shkatërruar.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Mikrofoni çaktivizuar] [Përkthim] Ju  
24 kërkoi falje, është hera e parë që unë nuk ndez mikrofonin.

25 Dëshmitar, desha t'ju pyes a ka ndonjë gjë që do të doje

1 të shtojë në lidhje me këtë?

2 PË. Jo.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kaq pyetje kisha unë,  
4 atëherë.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Nuk ka përkthim]

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit Gjykatësi  
7 Smith.

8 Dhe mirëdita, Dëshmitar. Kam edhe unë disa pyetje shtesë  
9 për ju.

10 Keni, ju kanë pyetur lidhur me vakumin që u krijua pas  
11 largimit të trupave jugosllave nga Kosova, a ju kujtohet që  
12 diskutuat në lidhje me këtë?

13 PË. Po.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A e dini ju pse ishte kaq  
15 e padëshirueshme për UÇK-në, pse nuk donte UÇK-ja ta  
16 plotësonte këtë vakum, me fjalë të tjera?

17 Atëherë, e dini ju pse nuk donin më saktë, desha të thoja  
18 unë, pse nuk donte komuniteti ndërkombëtar dhe KFOR-i që ta  
19 plotësonte UÇK-ja këtë vakum që ishte krijuar?

20 PË. Në bazë të rregullave të KFOR-it forca duhej, edhe kjo  
21 forcë duhej çarmatosur, kjo ka qenë arsyeja. Sigurisht dhe për  
22 të rivendosur rendin dhe sigurinë publike dhe për të mos  
23 lejuar masakrat ndaj serbëve që kishin mbetur atje dhe të  
24 tjerëve. Kështu që nga ana e KFOR-it asnjë autoritet Kosovar  
25 nuk duhej ta kryente atë detyrë.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nuk dua të t'i them unë  
2 fjalët, t'i vendos në gojë, por ju e keni fjalën që mund të  
3 kishte akte hakmarrjeje, mund të kishte hakmarrje qoftë nga  
4 popullata civile, por edhe nga anëtarët e UÇK-së, këtë deshët  
5 të thonit?

6 PË. Qëllimi ishte të parandalohet çdo lloj hakmarrjeje  
7 pavarësisht se nga buronte kjo hakmarrje.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në rregull. A është e  
9 drejtë që pasi hyri KFOR-i në Kosovë dikund mes 11 dhe 14  
10 qershorit të 1999 UÇK-ja vijoi të operonte dhe për disa muaj  
11 të tjerë?

12 PË. Nuk besoj. UÇK-ja u çarmatos relativisht shpejt në bazë  
13 të rregullave që ishin përcaktuar me përjashtim të ndonjë  
14 rasti të caktuar. Javët e para KFOR-i arriti të konsolidonte  
15 pozicionin e vet, si dhe organizatat e tjera erdhën në rajon  
16 përfaqësues të sistemeve të policisë dhe të drejtësisë, për të  
17 krijuar një rend të ri.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Atëherë po jua bëj pyetjen  
19 në këtë formë. A ju kujtohet kur filloi procesi i  
20 demilitarizimit të UÇK-së dhe kur përfundoi më saktë ky  
21 proces?

22 PË. Besoj se deri në fund të qershorit ishin çarmatosur.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kur thoni ishin  
24 çarmatosur, e keni fjalën për Kosovën në tërësi apo e keni  
25 fjalën për zonën ku vepronit ju dhe kolegët tuaj?

1 PË. Rregullat e çarmatosjes të UÇK-së vlenin për të gjithë  
2 forcën e KFOR-it. Besoj se deri në fund të qershorit pjesa më  
3 e madhe e UÇK-së ishte çarmatosur. Edhe që nga ky moment dhe  
4 në vijim, uniformat filluan të zhdukeshin nga rrugët.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në rregull. Do t'ju pyes  
6 lidhur me diçka që ju pyeti dhe Mbrojtja, por edhe Gjykatësi  
7 Barthe.

8 Me sa keni ju dijeni, shqiptarët e Kosovës, civilët, vetë  
9 civilët, a kanë krijuar ndonjëherë ambiente ndalimi?

10 PË. Me sa kam unë dijeni, jo.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kur them ambiente ndalimi  
12 flas për ambiente ndalimi që i keni dëshmuar vetë, siç ishte  
13 rasti i MUP-it, dhe këto ambiente sipas jush ishin, ruheshin  
14 prej UÇK-së, kështu?

15 PË. Kur liruan të burgosurit, gjetëm persona atje që ishin me  
16 siguri anëtarë të UÇK-së.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, personat që ju liruat  
18 deri në ato momente, kishin qenë nën kontrollin e UÇK-së, të  
19 ndaluar prej UÇK-së, kështu?

20 PË. Po, kështu supozoj.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju pyeti z. Roberts, që  
22 është Avokati i z. Selimi, ai bëri disa pyetje lidhur me  
23 autoritetin e KFOR-it apo kompetencat që kishte KFOR-i për të  
24 ndaluar dhe për të arrestuar personat e dyshuar si kriminelë.  
25 Ju kujtohet kjo linjë pyetjesh, Dëshmitar?



1 PË. Po, më kujtohet.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Unë kam përpara një  
3 dokument që mban datën 4 korrik 1999. Është dokument i UNMIK-  
4 ut, Misioni në Kosovë, e ka titullin "Një deklaratë lidhur me  
5 të drejtat e KFOR-it për të ndaluar dhe arrestuar persona".  
6 Këtu thuhet se kompetenca e KFOR-it për të ndaluar dhe  
7 arrestuar persona bazohej në Rezolutën e Këshillit 1244,  
8 Rezolutën e Sigurisë, të Këshillit. Edhe veçanërisht është e  
9 përcaktuar në këtë rezolutë.

10 Dëshmitar, a ju kujtohet ky dokument që është nënshkruar  
11 nga Përfaqësuesi i Posaçëm dhe Sekretari i Përgjithshëm i  
12 Kombeve të Bashkuara, Sergio Vallero [Sipas përkthimit] de  
13 Mello?

14 PË. Po, më kujtohet. Aty në fakt përshkruheshin dhe detyrat  
15 që do të kishte KFOR-i.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Deklarata kërkonte që  
17 KFOR-i të respektonte standardet e njohura ndërkombëtarisht  
18 për të drejtat e njeriut dhe kërkonte që emri i personit të  
19 ndaluar t'i raportojë menjëherë prokurorëve të sapoemëruar  
20 nga UNMIK-u dhe më pas gjykatësve hetues apo personat që  
21 kishin funksione gjyqësore, sipas rrethanave.

22 A ju kujtohet të ketë ndodhur kjo ditët e para të  
23 korrikut 1999?

24 PË. Sikurse jua përmenda edhe më përpara, gjykatësit e parë  
25 ishin atje në fillim të korrikut. Ishin dërguar prej UNMIK-ut.

1 Po.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit për  
3 përgjigjet tuaja.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi  
5 Gaynor?

6 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit.

7 Dëshmitar, në vitin 1999, keni qenë gati 30 vjet oficer  
8 ushtarak karriere, kështu?

9 PË. 29 vjet, i takonte në 1999.

10 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pra, në këtë periudhë, gjatë  
11 kësaj kohe ju keni marrë udhëzime dhe kishit mësuar lidhur me  
12 të drejtën ndërkombëtare humanitare, kështu?

13 PË. Po.

14 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A keni qenë në dijeni lidhur  
15 me detyrimet që ka një palë e caktuar në një konflikt të  
16 armatosur për të hetuar dhe sipas rastit për të ndjekur  
17 penalisht cenimet serioze të të drejtës ndërkombëtare  
18 humanitare?

19 PË. Po.

20 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Gjatë kohës që keni shërbyer  
21 në Kosovë, a keni menduar ju që si pala serbe dhe si pala e  
22 UÇK-së sipas jush kishin detyrimin, kishin qenë në situata kur  
23 u ishte dashur që të hetonin shkelje serioze të kryera prej  
24 anëtarëve të forcave të tyre të armatosura?

25 PË. Po, të paktën teorikisht.

1 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Dhe ju na thatë që në  
2 mandatin e KFOR-it përfshihej dhe detyrimi për rivendosjen e  
3 rendit publik në Kosovë. Por a mendoni ju se mandati i KFOR-it  
4 në njëfarë mënyre mbivendosej me detyrimin e UÇK-së për të  
5 hetuar shkeljet e rënda të kryera prej forcave të veta?

6 PË. Jo.

7 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Nga sa keni vrojtuar ju si  
8 anëtar i KFOR-it, sipas jush, UÇK-ja, kishte marrë, kishte  
9 ndërmarrë hapa apo të paktën ishte përpjekur më së paku që të  
10 hetonte krimet e kryera prej forcave të veta?

11 PË. Nuk di asgjë në lidhje me këtë.

12 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A keni pasur ndonjëherë  
13 diskutime me anëtarë të UÇK-së ku ata të kenë shprehur  
14 dëshirën apo vullnetin për të hetuar krimet që kishin kryer  
15 anëtarët e forcave të tyre, vetë forcat e tyre?

16 PË. Sa më takon mua, unë personalisht nuk kam biseduar  
17 asnjëherë në lidhje me këto.

18 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po a keni parë gjë që të  
19 linte të kuptoje se kishte gatishmëri apo vullnet nga ana e  
20 UÇK-së për të hetuar krimet e kryera prej forcave të tyre?

21 PË. Jo.

22 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Nuk kam më pyetje.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]  
24 [Përkthim] A ka ndonjë pyetje plotësuese prej Prokurorisë  
25 bazuar në pyetjet e Gjykatësve?

1 Faleminderit, po ngaqë po i afrohem kohës së pushimit, a  
2 mund të më thoni ekipet e Mbrojtje nëse kanë pyetje?

3 Znj. Tavakoli.

4 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Ka të ngjarë që po.

5 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Po, mund të kem një pyetje.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
7 Mirë, bëjmë pushimin e drekës tani.

8 Dëshmitar, do bëjmë një orë e gjysmë pushim, do të  
9 rikthehem në orën 14.30 që të përfundojmë me dëshminë tuaj.

10 Tani mund të largoheni nga salla e gjyqit.

11 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

12 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rikthehem në  
14 orën 14.30.

15 --- Pauza e drekës fillon në orën 12.59

16 --- Seanca rifillon në orën 14.30

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

18 [Dëshmitari vijon dëshminë]

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,  
20 Dëshmitar, jemi gati të vazhdojmë më tej.

21 Znj. Tavakoli ka disa pyetje për ju tani.

22 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Faleminderit.

23 Pyetje vijuese të palës tjetër nga znj.

24 Tavakoli:

25 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

1 PY. Kam disa pyetje për ju, Dëshmitar. Mendoj që Gjykatësi  
2 Barthe ju bëri një pyetje lidhur me faktin se kush mendonit ju  
3 që ishin të ndaluarit në goditën e MUP-it. Dhe ju thatë në  
4 përgjigje të kësaj pyetje që kishit dëgjuar që ata ishin  
5 bashkëpunëtorë. A ju kujtohet kjo pyetje dhe kjo përgjigje,  
6 Dëshmitar?

7 PË. Po.

8 PY. Dua të di në qoftë se keni dëgjuar gjithashtu kur keni  
9 qenë në terren, pra keni dëgjuar që komandant i UÇK-së ose më  
10 konkretisht komandanti Drini të ketë thënë që të burgosurit  
11 janë kriminelë?

12 PË. Jo.

13 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Referenca për këtë në qoftë se  
14 është e interesuar Gjykata është prova materiale P1188.2

15 PY. Tani do të vazhdojmë me pyetjen tjetër. Gjykatësi Gaynor  
16 ju bëri një pyetje lidhur me detyrimet e një pale në një  
17 konflikt të armatosur për të bërë hetime dhe sipas rregullave  
18 dhe për të bërë edhe -- për të dhënë edhe dënime për shkelje  
19 të së drejtës ndërkombëtare. A ju kujtohet kjo pyetje,  
20 Dëshmitar?

21 PË. Po.

22 PY. Ju u pajtuat me të, që edhe serbët edhe UÇK-ja ishin të  
23 detyruar që të hetonin shkelje të dhunshme që ishin kryer nga  
24 anëtarët e forcave të tyre të armatosura. Dhe përgjigja juaj  
25 ishte që "Po, të paktën teorikisht ky duhet të kishte qenë

1 rasti".

2 PË. Po.

3 PY. Ju lutem na e shpjegoni pak më tej. Çfarë doni të thoni  
4 kur thoni që të paktën teorikisht duhej të kishte qenë kështu?  
5 Na e shpjegoni pak.

6 PË. Ajo çfarë dua të them që formacionet e armatosura ose  
7 ushtritë kanë detyrimin që të bëjnë inspektime në raste të  
8 tilla. Megjithatë, unë isha i ndërgjegjshëm për faktin që të  
9 paktën asokohe kjo ishte një detyrë që nuk kishte nisur ende.

10 PY. Faleminderit. A mund t'ju pyes nëse e dini që në  
11 rrethanat e veçanta ligjore të situatës së pasluftës së  
12 Kosovës, që UNMIK-u dhe TPNJ-ja dhe policia e UNMIK-ut ishin  
13 autoritetet kompetente për të hetuar krimet në pajtim me  
14 Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara  
15 numër 1244?

16 PË. Unë e di se pas hyrjes së forcave të KFOR-it këto  
17 organizata kishin detyrën që të bënin ekzaktësisht këtë që  
18 përshkruat ju.

19 PY. Shumë faleminderit.

20 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Në qoftë se Trupi Gjykues  
21 kërkon referencën, kjo referencë është prova materiale 1D84.  
22 Nuk kam pyetje të tjera për këtë dëshmitar.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

24 Znj. O'Reilly, fjala për ju.

25 Pyetje vijuese të palës tjetër nga znj.

1 O'Reilly:

2 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim]

3 PY. Mirëdita, Dëshmitar. Përpara sesa të bënim pushimin e  
4 drekës ju bëri një pyetje Gjykatësi Barthe. Për procesverbal  
5 është në faqen 65 të transkriptit. Pyetja kishte të bënte me  
6 djegien e shtëpive. Në veçanti të shtëpive serbe. A ju  
7 kujtohet kjo pyetje, Dëshmitar?

8 PË. Po.

9 PY. Dëshiroj t'ju tregoj një fletë të ditarit tuaj.

10 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Për Sekretaren faqja e parë e  
11 këtij dokumenti është 071142 dhe do i kërkoja Sekretares që të  
12 shkojë tek faqja që përfundon me 1172. Është faqja me të  
13 njëjtin numër si në versionin gjermanisht ashtu dhe në atë në  
14 anglisht. Po presim që të transmetohet në anglisht. Ju kërkoj  
15 ndjesë për vonesën. Faleminderit Sekretares.

16 PY. Atëherë në paragrafin në mes thuhet që:

17 "Serbët që po largoheshin thonin që po i kishin vënë  
18 zjarrin -- po i vinin zjarrin shtëpive të tyre gjithmonë e më  
19 tepër."

20 A mund ta shpjegoni Dëshmitar, pse e thonin serbët këtë?  
21 Pse i kishin po i vinin zjarrin shtëpive të tyre ndërsa  
22 largoheshin?

23 PË. Në atë kohë, në fakt edhe e njëjta gjë është e zbatueshme  
24 edhe sot, mënyra sesi e shpjegojnë këtë situatë është si më  
25 poshtë: Askush pasi ishte larguar nuk donte që t'ja linte

1 askujt shtëpinë e vet. Domethënë pasi të largohej nuk donte që  
2 t'i dikush tjetër ta merrte shtëpinë e vet.

3 PY. Domethënë po thoni që po i digjnin shtëpitë e tyre në  
4 mënyrë që të mos lejonin shqiptarët që të shkonin të përdornin  
5 shtëpitë e tyre. Këtë po thoni, Dëshmitar?

6 PË. Sa i takon dëshirës për ta bërë këtë, ne jemi informuar  
7 pjesërisht lidhur me këtë gjë, kështu që në përgjigje të  
8 pyetjes mund të them po.

9 PY. Faleminderit. Nuk kam pyetje të tjera.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Roberts,  
11 keni fjalën ju.

12 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Roberts:

13 Z. ROBERTS: [Përkthim]

14 PY. Mirëdita, Dëshmitar. Kam pesë minuta për t'ju bërë  
15 pyetje. Së pari dua që të bëj një pyetje plotësuese ndaj  
16 pyetjes që iu bë nga avokatja e z. Thaçit që kishte të bënte  
17 me pyetjen e bërë nga Gjykatësi Gaynor lidhur me detyrimin e  
18 UÇK-së për të hetuar shkelje të rënda të kryera prej forcave  
19 të veta.

20 A ju kujtohet kjo pyetje, Dëshmitar?

21 PË. Po.

22 PY. Ju thatë që ata nuk kishin filluar ende. Domethënë është  
23 përgjigja që thatë në pyetjen e lidhur me detyrimin teorik.

24 Thatë që nuk kishin filluar akoma. A besoni se kjo kishte  
25 ndodhur për shkak të faktit që të veprimeve të KFOR-it për



1 çarmatimin e tyre ose shpërbërjen e pikave të kontrollit dhe  
2 për faktin që KFOR-i ishte organi kryesor publik për sa i  
3 takon vendosjes së rendit në Kosovë në të njëjtën kohë?

4 PË. Unë nuk di asgjë lidhur me përpjekjet e UÇK-së lidhur me  
5 kontrollin për gjëra të tilla. Për shkak të situatës, ditët e  
6 para pas hyrjes tonë atje, kjo nuk ishte diçka që pritej prej  
7 tyre. Në qoftë se kjo është bërë apo jo më pas këtë nuk ja u  
8 them dot.

9 PY. Por, a e pranoni që ka të ngjarë që veprimet tuaja të  
10 kenë pasur një ndikim domethënës mbi aftësinë apo kapacitetin  
11 e tyre për të kryer hetime të kësaj natyre?

12 PË. Kjo është diçka që nuk e vlerësoj dot.

13 PY. E kuptojmë.

14 Z. ROBERTS: [Përkthim] Tani do të kaloj tek disa pyetje  
15 që u bënë nga Gjykatësi Mettraux. Ju kërkoj falje që po i  
16 drejtohem Trupit Gjykses, por do të më ndihmonit në qoftë se  
17 më jepni një përgjigje për pyetjen që sapo do të bëj. A mund  
18 të më ndihmoni pak me referencën për pyetjen që u bë nga z.  
19 Mettraux?

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nuk besoj se ka një numër  
21 ERN por mund ta gjeni online sepse është një dokument publik.

22 Z. ROBERTS: [Përkthim] Domethënë në qoftë se nuk e kam  
23 gabim i takon që nuk është nxjerrë për Mbrojtjen ky dokument  
24 nga Prokuroria në këtë rast konkret.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nuk e di, nuk e kam

1 kontrolluar.

2 Z. ROBERTS: [Përkthim] Me çfarë kuptuam neve dhe nga  
3 kontrollet që kemi bërë, ky nuk është një dokument i cili nuk  
4 është -- i cili është paraqitur nga Prokuroria. Ju kërkoj  
5 ndjesë për këtë ndërhyrje por thjesht doja të dija që situata  
6 ishte e qartë sa i takon statusit të këtij dokumenti.

7 PY. Ky është një dokument që e përmendi Gjykatësi Mettraux në  
8 pyetje e veta. Do të lexoj ekzaktësisht atë çfarë tha ai:

9 "Përpara kam një dokument që mban datën 4 korrik 1999 nga  
10 Misioni i Administratës së Përkohshme së UNMIK-ut në Kosovë.  
11 Quket një 'Deklaratë për të drejtën e KFOR-it për të kapur dhe  
12 për të ndaluar'. Sugjeron që kompetenca e KFOR-it për të  
13 ndaluar dhe për të kapur individë mbështetet në Rezolutën e  
14 Këshillit të Sigurimit 1244 në këtë deklaratë konkrete."

15 Dhe më pas ai ju pyeti në qoftë se e mbani mend këtë  
16 dokument dhe ju thatë "po". Më pas ai ju pyet në qoftë se kjo  
17 deklaratë kërkon që KFOR-i të respektojë të drejtën  
18 ndërkombëtare humanitare.

19 Pyetja që kam unë për ju tani është kjo: A e mbani mend  
20 juve, a jeni të vetëdijsëm, ose a e dini në qoftë se kjo datë  
21 ka të bëjë me bazën konkrete ligjore për ndalimin e njerëzve  
22 në KFOR, nga KFOR-i, pra.

23 PË. Jo, por gjatë kësaj periudhe kohe ne kemi parë që  
24 gjithmonë e më tepër në të përditshëm, në aktivitete të  
25 përditshme policia ndërkombëtare ka marrë përsipër detyra të

1 tilla.

2 PY. Përsëri për këtë çështje. A ke parë ndonjë rast gjatë  
3 kohës kur keni qenë në Kosovë që dikush që ishte ndaluar ka  
4 dalë përpara një gjykate ose një gjykatësi? A ju kujtohet  
5 ndonjë rast i tillë, Dëshmitar?

6 PË. I arrestuar, po. Pastaj sa i takon transferimit përpara  
7 Gjykatës këtë rast nuk më kujtohet diçka e tillë. Gjatë fazës  
8 së parë nuk kishte gjykata të krijuara.

9 PY. Në rregull.

10 Z. ROBERTS: [Përkthim] Do i kërkoj Sekretares që të  
11 paraqesë në ekran dokumentin DRS00632. Është një raport nga  
12 Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës me titull  
13 "Evropa Jug-Lindore dhe Kosova, Vlerësimi i Situatës  
14 Humanitare në Republikën Federale të Jugosllavisë, në veçanti  
15 në Kosovë dhe në Mal të Zi". Mban datën 18 shtator 1999.  
16 Domethënë i takon që është dy muaj e gjysmë pas deklaratës nga  
17 z. De Milo [Sipas përkthimit].

18 Do kërkoja që të kalojmë te paragrafi 13, është faqja e  
19 tretë, është DRS00636. Do ta lexoj. Në fund të kësaj faqeje.  
20 Do t'i kërkoja Sekretares ta kalojë faqen drejt fundit. Edhe  
21 pak më poshtë, ndoshta është faqja tjetër.

22 Do ta lexoj për procesverbal. Duket sikur ka një problem  
23 me atë çfarë transmetohet në ekran. Megjithatë do ta lexoj  
24 edhe një herë numrin ERN. Për faqen që më intereson numri ERN  
25 është DRS00636. Mendoj se është fundi i faqes tjetër dhe jo i

1 faqes që kemi përpara.

2 PY. Pra, kjo është faqja. Në paragrafin 18 që trajton po  
3 ashtu Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të  
4 Bashkuara 1244, thuhet më konkretisht:

5 "Sipas Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të  
6 Bashkuara numër 1244, data 10 qershor 1999, KFOR-i ka mandatin  
7 dhe përgjegjësinë për të siguruar rendin publik dhe sigurinë  
8 publike derisa Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë  
9 (UNMIK) të marrë përgjegjësi të plotë lidhur me vendosjen e  
10 rendit civil dhe ligjit në Kosovë. Megjithatë, KFOR-i as nuk  
11 ishte trajnuar dhe pajisur për policim. Nuk kishte as mjete  
12 dhe as bazë ligjore për të ndaluar të dyshuar apo për të bërë  
13 hetime. Për më tepër nuk kishte autoritet legjitim për të  
14 gjykuar personat e akuzuar për kryerjen e krimeve."

15 Pra, kjo ka ndodhur, ky është një raport që është nxjerrë  
16 dy muaj e gjysmë pas deklaratës që u përmend nga Gjykatësi  
17 Mettraux dhe duket nga ky paragraf që kishte shqetësime të  
18 konsiderueshme sa i takon ligjshmërisë së ndalimit të  
19 njëerzëve. Ju nuk ishit i vetëdijsëm për këtë, fare, apo jo,  
20 Dëshmitar?

21 PË. Më pas, domethënë pasi u ktheva në shtëpi kam lexuar  
22 lidhur me çështje të tilla. Megjithatë gjatë dislokimit tim  
23 atje, në veçanti gjatë ditëve dhe javëve pas hyrjes në Kosovë  
24 kjo nuk ka qenë temë fare për neve. Ne ishim të zënë duke  
25 vendosur ligjin, sigurinë, rregullin dhe për shkak të kësaj

1 Rezolute të Kombeve të Bashkuara ekzistonte gjithashtu e  
2 drejta për të arrestuar dhe për të ndaluar persona.  
3 Megjithatë, kjo është diçka që mund ta them sot. Dhe unë jam  
4 një person që nuk ka përvojë juridike. Nuk jam i trajnuar në  
5 aspektin ligjor.  
6 PY. Po. Për të qenë e drejtë, ndoshta kjo shërben edhe për të  
7 bërë një përmbledhje të qëndrimit tuaj, pra në kohën kur keni  
8 qenë atje ju e keni ndjerë që kishit detyrimin që të siguronit  
9 dhe që të vendosnit rendin edhe sigurinë. Dhe kjo sipas jush  
10 ju lejonte ju që të ndalonit personat në qoftë se ata do t'i  
11 gjenit në një situatë krimi. Domethënë, jo në mes të një  
12 luftimi, por në një situatë problematike, ju e besonit ose e  
13 ndjenit që e kishit një përgjegjësi të tillë. Mund ta bënit  
14 diçka të tillë. A është një vlerësim i drejtë ky, Dëshmitar?  
15 PË. Unë mendoj që KFOR-i kishte të drejtë që ta bënte këtë  
16 gjë dhe supozoj që KFOR-i e ka bërë këtë gjë.

17 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit. Nuk kam pyetje të  
18 tjera.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Baiesu  
20 keni pyetje?

21 Z. BAIESU: [Përkthim] Jo, nuk kam pyetje të tjera.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,  
23 Dëshmitar. Faleminderit për kohën. Kemi përfunduar këtu me  
24 dëshminë tuaj.

25 Po ashtu dëshiroj të falënderoj përkthyesit gjermanë që

1 kanë qenë me ne për këto dy ditë. Keni bërë punë të shkëlqyer,  
2 siç bëjnë të gjithë përkthyesit tanë. Kështu që faleminderit  
3 shumë, Dëshmitar. Mund të largoheni nga salla. Ju urojmë  
4 gjithë të mirat. Faleminderit.

5 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

6 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të bëjmë  
8 një pushim prej 10 minutash në mënyrë të tillë që Prokuroria  
9 të organizohet për dëshmitarin e radhës. Atëherë do të bëjmë  
10 pushim 10 minuta, do të mblidhemi përsëri në orën 3.00.

11 --- Seanca ndërpritet në orën 14.49

12 --- Seanca rifillon në orën 15.00

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem, të  
14 kalojmë në seancë private.

15 [Seancë private]

16 [Seancë private teksti i fshirë]

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19 [Seancë e hapur]

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përpara se të  
22 fillojmë me Dëshmitarin e Prokurorisë 04710, kam një urdhër me  
23 gojë.

24 Sot, ZPS-ja ka dorëzuar parashtim e protokolluar

25 F023727, konkretisht është një kërkesë për dëshmi përmes

1 videolidhjes për dy dëshmitarë që janë njoftuar si dëshmitarë  
2 rezervë për bllokun e radhës së dëshmitarëve. ZPS-ja ka  
3 kërkuar që të bëhet një organizim i përsheptuar për këta  
4 dëshmitarë.

5 Trupi Gjykses informon palët, pjesëmarrësit dhe Zyrën  
6 Administrative se përgjigjet për parashtrim e protokolluar  
7 02327 dhe parashtrimet e Zyrës Administrative sa i takon  
8 realizimit apo plotësimit të kësaj kërkesë, duhet të jepet  
9 nesër, pra, çdo parashtrim duhet të jepet nesër me gojë në  
10 sallën gjyqit. Nuk do të shqyrtohen kundërpërgjigje lidhur me  
11 këtë aspekt.

12 Tani mund të vazhdojmë.

13 Z. Ellis, vazhdoni.

14 Z. ELLIS: [Përkthim] Ne mund ta japim përgjigjen që tani  
15 në fakt. Ne diskutuam me kolegët, me njëri-tjetrin dhe ramë  
16 dakord që nuk kemi asnjë kundërshtim për videolidhjet.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka njeri për  
18 të thënë gjë sot apo doni të flisni nesër.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

20 Z. TULLY: [Përkthim] As ne nuk kemi kundërshtim për  
21 videolidhjen.

22 Z. EMMERSON: [Përkthim] As ne nuk kemi kundërshtime për  
23 videolidhjen.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Okej. Kjo i  
25 thjeshtoi gjërat. Atëherë do të lejohet dëshmia përmes



1 videolidhjes për këta dy dëshmitarët - ne do të nxjerrim një  
2 urdhër me gojë - bazuar në pëlqimin që kanë dhënë palët.

3 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

4 DËSHMITARI: Mirëdita.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëdita,  
6 Dëshmitar. Asistentja e Sallës së gjyqit do t'ju japi një  
7 tekst që është betimit solemn dhe të cilin duhet ta lexoni në  
8 bazë të rregullave të Gjykatës. Ju lutem lexoni me zë tekstin  
9 që keni përpara dhe kur të mbaroni së lexuari do ju pyes nëse  
10 pajtoheni me këtë tekst.

11 DËSHMITARI: Ta filloj?

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Filloni.

13 DËSHMITARI: Betimi solemn sipas rregullës 141(2): I  
14 ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë sime dhe përgjegjësinë  
15 time ligjore, deklaroj solemnisht se do të them të vërtetën,  
16 krejt të vërtetën dhe vetëm të vërtetën dhe nuk do të mbaj të  
17 fshehtë asgjë për të cilën kam dijeni.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,  
19 pajtoheni me betimin solemn?

20 DËSHMITARI: Sigurisht, po.

21 DËSHMITARI: W04710

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të uleni  
23 tani.

24 Dëshmitar, sot do fillojmë me dëshminë tuaj që mendohet  
25 se do të zgjasë rreth një ditë.

1 Fillimisht do t'i bëj pyetjet Prokuroria, më pas kanë të  
2 drejtën Ekipet e Mbrojtjes t'ju bëjnë pyetje dhe mund të kenë  
3 pyetje dhe Gjykatësit.

4 Prokuroria ka parashikuar një orë për pyetjet e veta.  
5 Ekipet e Mbrojtjes, së bashku, kanë kërkuar katër orë e  
6 gjysëm. Inkurajojë të gjitha palët të jenë sa më të kujdesshëm  
7 në shfrytëzimin e kohës. Trupi Gjykues mund të lejojë pyetje  
8 plotësuese nëse përmbushen kushtet.

9 Dëshmitar, përgjigjuni qartë, me fjali të shkurtra. Nëse  
10 nuk e kuptoni një pyetje, lirisht kërkon që pyetja të  
11 përgjigjet ose thjesht thoni që nuk e kuptoni që ta sqarojmë.

12 Gjithashtu, na thoni ku e bazoni njohurinë tuaj për  
13 faktet dhe për rrethanat për të cilat do t'ju bëjnë pyetje.

14 Në rast se ZPS-ja ju kërkon të flisni për korrigjimet që  
15 ju keni bërë tek deklaratat tuaja, ju lutem thoni me zë për  
16 procesverbal që deklarata me shkrim, bashkë me korrigjimet që  
17 keni bërë, pasqyron saktësisht dëshminë tuaj.

18 Flisni pranë mikrofonit edhe prisni pesë sekonda përpara  
19 sesa të përgjigjeni, si dhe flisni ngadalë për përkthyesit.

20 Gjatë kohës që jepni dëshmi në sallën e gjyqit, nuk duhet  
21 të diskutoni me asnjë person përmbajtjen e dëshmisë suaj. Nëse  
22 një person jashtë sallës së gjyqit, të bën pyetje për  
23 dëshminë, menjëherë na njoftoni.

24 Trupi Gjykues e kupton që ZPS-ja ka disa deklarata, pra,  
25 disa kopje fizike të deklaratave të mëparshme që keni dhënë

1 ju, që mund të keni nevojë të shikoni në qoftë se nuk ju  
2 kujtohet diçka dhe doni t'i shikoni këto dokumente. Ju lutem  
3 na njoftoni ne paraprakisht. Ama mund t'i shikoni këto  
4 dokumente vetëm në rastet se nuk ju kujtohet diçka. Nuk duhet  
5 të lexoni tekstin e këtyre dokumenteve.

6 Gjithashtu, nëse unë them të mos flisni më, pushoni së  
7 foluri dhe gjithashtu mos flisni më nëse unë ngre dorën. Se  
8 kjo do të thotë që unë dua të them diçka.

9 Nëse do keni nevojë për një pushim, na thoni që të bëjmë  
10 organizimin përkatës.

11 Do të fillojmë tani me pyetjet e Prokurorinë që janë në  
12 të majtën tuaj.

13 Znj. Prokurore, a do të jemi në seancë private?

14 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Mund të fillojmë në seancë  
15 publike dhe më pas të kalojmë në seancë private.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

17 Pyetje nga znj. Insinga:

18 ZNJ. INSINGA: [Përkthim]

19 PY. Mirëdita, Dëshmitar.

20 PË. Mirëdita.

21 PY. Jemi takuar dhe më përpara po unë sidoqoftë do të  
22 prezantohem dhe një herë. Jam Alexandra Insinga dhe punoj për  
23 ZPS-në.

24 Siç ta shpjegova gjatë seancës përgatitore javën e  
25 kaluar, unë nuk bëj pyetje për çdo aspekt të mundshëm por

1 është e mundur që të pranohen disa nga deklaratat që ke dhënë  
2 më përpara si pjesë e provave gjyqësore. Sidoqoftë për ta bërë  
3 këtë duhet të ndjekim disa hapa proceduralë.

4 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, për pyetjet  
5 e para dhe për mbrojtjen e identitetit të dëshmitarit do  
6 lutesha të kalonim në seancë private.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kalojmë në  
8 seancë private.

9 [Seancë private]

10 [Seancë private teksti i fshirë]

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24 [Seancë e hapur]

25 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

1 ZNJ. INSINGA: [Përkthim]

2 PY. Dëshmitar, tani jemi në seancë publike, po pyetjet që do  
3 të bëjë unë nuk do t'ju identifikojnë.

4 Dëshmitar, a të ka intervistuar më përpara Zyra e  
5 Prokurorit të Specializuar?

6 PË. Po. Në Prishtinë.

7 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Tani do lutesha që Sekretaria e  
8 Gjykatës të nxjerrë në ekran materialin që mban numrin 091696-  
9 TR-AT Pjesa 1 RED2, faqja 1. Dhe nuk është për publikun.

10 PY. Dëshmitar, pa e përmendur emrin tënd dhe asnjë  
11 informacion tjetër që të identifikon, kjo faqja që po sheh ti  
12 në ekran përballë, a është intervista që ke dhënë për ZPS-në?

13 PË. Po.

14 PY. A të është dhënë mundësia kohët e fundit ta lexoni edhe  
15 një herë intervistën që keni dhënë?

16 PË. Më duket e panevojshme, po nëse doni, e lexoj.

17 PY. Jo, ju kërkohet ndjesë. Do ta bëj dhe një herë pyetjen.

18 Dëshmitar, kohët e fundit a tu dha mundësia ta lexoje dhe një  
19 herë këtë intervistën që kishe dhënë më përpara, ta rilexoje  
20 pra?

21 PË. Okej. Me zë? Me zë me lexu apo?

22 PY. Jo, Dëshmitar.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo.

24 Dëshmitar, dëgjoje me vëmendje pyetjen. Po ju pyet për diçka  
25 tjetër.

1 ZNJ. INSINGA: [Përkthim]

2 PY. Dëshmitar, javën e kaluar kur u takuam a e lexove dhe një  
3 herë këtë intervistën që ke përpara në ekran?

4 PË. Po, po.

5 PY. Dhe javën e kaluar gjatë seancës përgatitore, a e mban  
6 mend që bërë disa ndryshime dhe disa sqarime te teksti i kësaj  
7 intervistës?

8 PË. Po.

9 PY. Kështu?

10 PË. Po. Po.

11 PY. Këto ndryshimet u hodhën në një shënim që ta lexuam prapë  
12 javën e kaluar, kështu?

13 PË. Po. Po ashtu është.

14 PY. A e konfirmoni që ato që ju lexuam javën e kaluar ne,  
15 pra, ndryshimet që bëtë, ishin të sakta dhe të plota?

16 PË. Të sakta e të plota kanë qenë.

17 PY. Tani duke e marrë parasysh dhe ndryshimet që t'i lexuam  
18 javën e kaluar, deklarata që ke përpara, bashkë me ndryshimet  
19 që ke bërë, a pasqyron saktësisht atë që ke thënë ti dhe atë  
20 që do thojë dhe sot në sallën e gjyqit nëse do të pyesnin për  
21 të njëjtat informata?

22 PË. Është e saktë çdo gjë që kam thënë në deklaratën e  
23 përparshme.

24 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, pasi kam  
25 përmbushur kriteret e rregullës 154 dhe në përputhje me

1 parashtimin e protokolluar F02245, ZPS-ja kërkon që të  
2 pranohen të tri pjesët e materialit me numër 091696-TR, bashkë  
3 me përkthimet përkatëse si dhe Shënimin Përgatitor numër 1 që  
4 mban numrin ERN 121098 deri në 121099, përfshirë këtu provat  
5 materiale shoqëruese të evidentuara në poshtëshënimin 140 të  
6 vendimit 02245.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka  
8 kundërshtime?

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo.

10 PËRKTHYESJA: Ekipet e Mbrojtjes nuk kanë kundërshtime.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
12 Materiali 091696-TR-ET Pjesa 1 RED2, bashkë me përkthimet  
13 përkatëse, pranohen në prova gjyqësore.

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Deklarata me numër  
15 091696 bashkë me përkthimin në anglisht dhe në shqip do të  
16 pranohen si prova materiale P01195.1. Kjo është Pjesa 1. Po  
17 kemi dhe dy pjesë të tjera.

18 Pjesa 2 me të njëjtin numër si anglishtja dhe shqipja  
19 pranohen dhe marrin numrin P01195.2.

20 Ndërsa Pjesa 3, anglishtja dhe shqipja pranohen si  
21 P01195.3.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni  
23 çaktivizuar]

24 Edhe Shënimi Përgatitor, ju lutem, numër 1 me numër  
25 0121098 deri në 0121099.

1 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Shënimi Përgatitor merr  
2 numrin e provës materiale P01196.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
4 Mund të vazhdoni.

5 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Ne kemi një përmbledhje të  
6 shkurtër që mund ta lexojmë në seancë publike për këtë  
7 dëshmitar dhe ia kemi dhënë dhe Ekipeve të Mbrojtjes.

8 Dëshmitari me numër 04710 është i afërm i një viktime që  
9 është vrarë dhe që është zhdukur nga Drenoci. Dëshmitari do të  
10 përshkruajë çfarë ka bërë kjo viktimë para se të zhdukej nga  
11 Drenoci, herën e fundit që e ka parë dëshmitari këtë persona  
12 dhe përpjekjet e shumta që kanë bërë anëtarët e familjes për  
13 të zbuluar se çfarë i ndodhi këtij personi.

14 I nderuar Gjykatës, për pjesën e mbetur të pyetjeve të  
15 mia do t'ju lutesha të kalonim në seancë private për të  
16 mbrojtur identitetin e dëshmitarit.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për të  
18 mbrojtur identitetin e dëshmitarit do të kalojmë në seancë  
19 private.

20 [Seancë private]

21 [Seancë private teksti i fshirë]

22

23

24

25



1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25



1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25



1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25



1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25



1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22 [Seancë e hapur]

23 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

25 Seanca mbyllet për sot.

1 --- Seanca mbyllet në orën 16.30

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25